



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.79

2004

8 nëntor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9282 datë 30.9.2004	Për ratifikimin e Protokollit shtesë të “Marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe, për sa i përket statusit të forcave të tyre”.....	5838
Ligj nr.9283 datë 30.9.2004	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së transportit ajror ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë për shërbimet ajrore ndërmjet dhe përtej territoreve respektive”.....	5841
Ligj nr.9284 datë 30.9.2004	Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar.....	5852
Ligj nr.9285 datë 30.9.2004	Për një ndryshim në ligjin nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.....	5862
Ligj nr.9286 datë 30.9.2004	Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr.8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”.....	5863
Ligj nr.9287 datë 7.10.2004	Për ratifikimin e Protokollit shtesë të Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale nga organet mbikëqyrëse dhe fluksi ndërkufitar i të dhënave”.....	5864
Ligj nr.9288 datë 7.10.2004	Për ratifikimin e Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”.....	5866

LIGJ
Nr.9282, datë 30.9.2004

**PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT SHITESË TË “MARRËVESHJES NDËRMJET
SHTETEVE PALË NË TRAKTATIN E ATLANTIKUT TË VERIUT DHE SHTETEVE
TË TJERA PJESEMARRËSE NË PARTNERITETIN PËR PAQE, PËR SA I PËRKET
STATUSIT TË FORCAVE TË TYRE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, më propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Protokollin shtesë i “Marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe, për sa i përket statusit të forcave të tyre”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur më dekretin nr.4369, datë 26.10.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

PROTOKOLL SHITESË

**I MARRËVESHJES NDËRMJET PALËVE NË TRAKTATIN E ATLANTIKUT TË VERIUT
DHE SHTETEVE TË TJERA PJESEMARRËSE NË PARTNERITETIN PËR PAQE PËRSA I
PËRKET STATUTIT TË FORCAVE TË TYRE**

Duke konsideruar marrëveshjen mes shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe, për sa i përket statusit të forcave të tyre dhe protokollit shtesë të kësaj Marrëveshjeje, bërë në Bruksel më 19 qershor 1995,

duke konsideruar nevojën për të vendosur dhe rregulluar statutin e shtabeve ushtarake të NATO-s dhe personelit të tyre në territorin e shteteve pjesëmarrëse në partneritetin për paqe, më qëllim lehtësimin e marrëdhënieve më forcat e armatosura të vendeve të ndryshme anëtare të PFP-së,

duke konsideruar nevojën për sigurimin e një statusi të përshtatshëm për personelin e forcave të armatosura të shteteve të lidhura ose të shoqëruara më shtabet ushtarake të NATO-s,

duke konsideruar që rrethanat për shtetet palë të NATO-s mund të kërkojnë plotësimin e nevojave të përshkruara më poshtë sipas mënyrave të këtij protokollit,

palët e këtij protokollit kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Për qëllimet e këtij protokollit, shprehja:

1. “Protokollin e Parisit” nënkupton “Protokollin për statusin e shtabeve ndërkombëtare ushtarake të vendosura në përputhje me traktatin e Atlantikut të Veriut”, bërë në Paris më 28 gusht 1952.

a) “Marrëveshja”, kudo që kjo shprehje përmendet në protokollin e Parisit, më të do të kuptohet Statusi i Forcave të NATO-s i zbatueshëm nga Marrëveshja mes Shteteve Palë në Traktatin e Atlantikut Verior dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe përsa i përket statusit të forcave të tyre, bërë në Bruksel më 19 qershor 1995.

b) “Forca” dhe “komponenti civil”, kudo ku përmenden në protokollin e Parisit, kanë kuptimet e përcaktuara në nenin 3 të protokollit të Parisit dhe do të përfshijnë personat e lidhur ose shoqërues të shtabeve të NATO-s nga shtetet palë pjesëmarrëse në Pfp.

c) “Vartës”, kudo ku përmendet në protokollin e Parisit, do të kuptojë bashkëshortin e një anëtari të forcës ose një komponenti civil siç përcaktohet në paragrafin b të këtij neni, ose një fëmijë të një anëtari të tillë që varet nga ai ose ajo.

2. “Pfp SOFA”, kudo ku përmendet në këtë protokoll, nënkupton “Marrëveshjen mes shteteve palë në Traktatin e Atlantikut Verior dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, bërë në Bruksel më 19 qershor 1995.

3. “NATO” nënkupton Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut.

4. Shtabet e NATO-s nënkupton shtabet aleate dhe shtabet ose organizatat ushtarake ndërkombëtare sipas nenit 1 dhe 14 të këtij protokollit.

Neni 2

Pa cenuar të drejtat e shteteve që janë anëtare të NATO-s ose pjesëmarrëse në Pfp, por që nuk janë palë të këtij protokollit, palët, veç kësaj, do të zbatojnë të njëjtat dispozita si ato të protokollit të Parisit, duke përjashtuar ato të ndryshuara në këtë protokoll, në lidhje me aktivitetet e shtabeve të NATO-s dhe personelit të tyre civil dhe ushtarak në territorin e një palë .

Neni 3

1. Veç territorit në të cilin zbatohet protokollin e Parisit, ky protokoll do të zbatohet në territorin e të gjitha shteteve palë të këtij protokollit, siç përshkruhet në nenin 2 paragrafi 1 të Pfp SOFA.

2. Për qëllime të këtij protokollit, referencat në protokollin e Parisit për zonën e Traktatit të Atlantikut Verior mendohet të përfshijnë territoret e reguara në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 4

Për qëllimet e zbatimit të këtij protokollit në lidhje me çështjet që përfshijnë shtetet partnere, dispozitat e protokollit të Parisit, të cilat shprehin ndryshime që kanë lidhje me Këshillin e Atlantikut të Veriut, do të jenë të tilla që t’i kërkojnë palëve të interesuara të negociojnë mes tyre pa iu drejtuar një juridiksioni të jashtëm.

Neni 5

1. Ky protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim nga çdo shtet që është nënshkrues i NATO-s Pfp.

2. Ky protokoll do të jetë subjekt i ratifikimit, pranimi ose miratimit. Instrumentet e tij të ratifikimit, pranimi ose miratimit do të depozitohen nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila do të njoftojë nënshkruesit për secilin depozitim.

3. Sapo dy ose më shumë shtete nënshkruese të kenë depozituar instrumentet e ratifikimit, pranimi ose miratimit, ky protokoll do të hyjë në fuqi përsa u përket këtyre shteteve. Ai do të hyjë në fuqi për secilin shtet nënshkrues në datën e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimi ose miratimit.

Neni 6

Ky protokoll mund të denoncohet nga secila palë e protokollit, më dhënien e një njoftimi të shkruar të denoncimit, Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila do të njoftojë të gjitha shtetet nënshkruese për një njoftim të tillë. Ky denoncim do të ketë efekt një vit pas marrjes së njoftimit nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pas kalimit të këtij afati njëvjeçar, ky protokoll do të shfuqizohet për palën denoncuese, përveç zgjidhjes së pretendimeve të lindura përpara datës në të cilën denoncimi do të ketë efekt, por do të vazhdojë të jetë në fuqi për palët e tjera.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Bruksel, më 19 dhjetor 1997, në gjuhën frënge dhe angleze, të dy tekstet më të njëjtën vlerë, më një origjinal të vetëm që do të depozitohet në arkivat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila do t'i komunikojë të gjitha shteteve nënshkruese kopje të vërtetuara.

LIGJ

Nr.9283, datë 30.9.2004

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË TRANSPORTIT AJROR NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË TURQISË PËR SHËRBIMET AJRORE NDËRMJET DHE PËRTEJ TERRITOREVE RESPEKTIVE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, më propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e transportit ajror ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë për shërbimet ajrore ndërmjet dhe përtej territoreve respektive”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur më dekretin nr.4370, datë 26.10.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJA

E TRANSPORTIT AJROR NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË TURQISË

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë,
duke qenë palë në Konventën e aviacionit civil ndërkombëtar dhe Marrëveshjes së shërbimeve transite ajrore ndërkombëtare, të hapura të dyja për nënshkrim në Çikago në datën

7.12.1944,

duke dashur të konkludojnë një marrëveshje suplementare të Konventës në fjalë, për qëllim të vendosjes së shërbimeve ajrore ndërmjet dhe përtej territoreve të tyre respektive,
duke dashur të sigurojnë shkallën më të lartë të sigurisë dhe të sigurimit të transportit ajror ndërkombëtar,
kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1 **Përkufizime**

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga konteksti kur e kërkon ndryshe:

a) termi “Konventë” nënkupton Konventën e aviacionit civil ndërkombëtar, të hapur për nënshkrim në Çikago në datën 7.12.1944 dhe që përfshin çdo aneks të përshtatur sipas nenit 90 të kësaj Konvente dhe çdo amendament të anekseve ose të Konventës sipas nenit 90 dhe 94 për aq kohë sa këto anekse dhe amendamente kanë hyrë në fuqi ose janë ratifikuar nga të dyja Palët Kontraktuese;

b) termi “autoritete aeronautike” nënkupton për Republikën e Shqipërisë, Ministrin e Transportit, në personin e Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil dhe çdo organ të autorizuar për të përmbushur çdo funksion të ushtruar nga Ministri në fjalë dhe në rastin e Republikës së Turqisë, Ministrin e Transportit dhe të Komunikacionit dhe çdo person ose organ të autorizuar për të përmbushur çdo funksion nga Ministri në fjalë;

c) termi “shoqëri ajrore e emëruar” nënkupton një shoqëri ajrore e cila përcaktohet dhe autorizohet në përputhje me nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje;

d) termi “territor” ka kuptimin që shprehet në nenin 2 të Konventës;

e) termat “shërbim ajror”, “shërbim ajror ndërkombëtar”, “shoqëri ajrore” dhe “ndalesë për qëllime jo të trafikut” kanë kuptimin që është shprehur në nenin 96 të Konventës;

f) termi “kapacitet” nënkupton:

- në lidhje me një avion, ngarkesën e pagueshme të këtij avioni, të vlefshme në një rrugë ose në një sektor rruge;

- në lidhje me një shërbim ajror të specifikuar, kapacitetin e avionit të përdorur në shërbime të tilla të shumëzuar me frekuencën e operimit nga një avion i tillë për një periudhë të dhënë dhe rrugë ose sektor rruge;

g) termi “trafik” nënkupton pasagjerë, bagazhe, mallra dhe postën;

h) termi “tarifë” nënkupton çmimin që duhet të paguhet për mbartjen e pasagjerëve, bagazheve dhe mallrave, si dhe kushtet nën të cilat këto çmime aplikohen, duke përfshirë komisionin e detyrimeve dhe të tjera shtesa të pagueshme për agjenci ose shitjen e dokumenteve të transportit, por duke përfshirë pagesën dhe kushtet për mbartjen e postës.

Neni 2 **Të drejtat e trafikut**

1. Çdo palë kontraktuese i garanton palës tjetër kontraktuese të drejtat e specifikuara në këtë Marrëveshje për qëllim të vendosjes së shërbimeve ajrore të rregullave ndërkombëtare në rrugë të specifikuara në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje. Shërbime të tilla dhe rrugët janë këtej e tutje, të quajtura respektivisht “shërbime të pranuar” dhe “rrugë të specifikuara”. Shoqëritë ajrore të emëruara nga çdo palë kontraktuese do të gëzojnë, ndërsa operojnë, një shërbim të pranuar në një rrugë të specifikuar, të drejtat si më poshtë:

a) për të fluturuar ndërmjet territorit të palës tjetër kontraktuese pa ulje;

b) për të bërë ndalesë në territorin në fjalë për qëllime jo të trafiku; dhe

c) për të bërë ndalesa në territorin, në pikën e specifikuar të kësaj rruge në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje për qëllim të vendosjes dhe të marrjes së trafikut ndërkombëtar të kombinuar ose të veçantë.

2. Asgjë në paragrafin 1 të këtij neni nuk duhet të gjykohet si konfirmim i shoqërisë ajrore të një palë kontraktuese, i privilegjit të marrjes në territorin e palës tjetër kontraktuese, mbartja e trafikut për shpërbim ose qira dhe të destinuara për pikën tjetër në territorin e asaj palë tjetër

kontraktuese.

Neni 3 **Autorizimi i operimit**

1. Çdo palë kontraktuese do të ketë të drejtën më anë të një njoftimi më shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike të palës tjetër kontraktuese, të emërojë një ose më shumë shoqëri ajrore për qëllim operimi të shërbimeve të pranuar në rrugët e specifikuar.

2. më marrjen e një emërimi të tillë, pala tjetër kontraktuese subjekt i parashikimeve 3 dhe 4 të këtij neni, pa vonesë t'i japë shoqërisë ajrore të emëruar autorizimet e duhura për operim.

3. Autoritetet aeronautike të njërës palë kontraktuese mund të kërkojnë një shoqëri ajrore të emëruar nga pala tjetër kontraktuese për të kënaqur ata dhe të jetë e kualifikuar të plotësojë kushtet e parashikuara të përshkruara nga ligjet dhe rregulloret që, normalisht dhe në mënyrë të arsyeshme, të aplikohen për operate të shërbimeve ajrore ndërkombëtare nga autoritete të tilla.

4. Çdo palë kontraktuese ka të drejtë të refuzojë dhënien e këtij autorizimi operues, që i referohet paragrafit 2 të këtij neni, ose ta japë këtë autorizim sipas kushteve që i konsideron të nevojshme për ushtrimin e të drejtave nga shoqëritë ajrore të emëruara të specifikuar në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje, në qoftë se nuk bindet së pronësia dhe kontrolli efektiv i asaj shoqërie ajrore i përkasin palës tjetër kontraktuese që e emëron shoqërinë ajrore ose të shtetasve të saj.

5. Kur një shoqëri ajrore është emëruar në këtë mënyrë dhe e autorizuar mund të fillojë në çdo kohë të operojë në shërbimet e pranuar, duke siguruar kapacitetin e pranueshëm dhe tarifa e vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 12 të kësaj Marrëveshjeje, që është në fuqi në lidhje me këtë shërbim.

Neni 4 **Revokimi dhe pezullimi i autorizimit të operimit**

1. Pala kontraktuese ka të drejtë të revokojë një autorizim ose të pezullojë ushtrimin e të drejtave të specifikuar në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje nga një shoqëri ajrore e emëruar nga pala tjetër kontraktuese, ose t'i imponojë kushte të tilla që mund t'i gjykojë të nevojshme në ushtrimin e këtyre të drejtave:

a) në rastin kur ata nuk binden që pronësia dhe kontrolli efektiv i shoqërisë ajrore i përkasin palës kontraktuese, që emëron shoqërinë ajrore ose shtetasve të saj;

b) në rastin kur shoqëria ajrore nuk vepron në përputhje me ligjet ose rregulloret e palës kontraktuese, që jep të drejtat;

c) në rastin kur shoqëria ajrore nuk operon në përputhje me kushtet e përshkruara sipas kësaj Marrëveshjeje.

2. Në qoftë se revokimi i menjëhershëm, pezullimi ose imponimi i kushteve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni është esencial për të parandaluar shkeljet e mëtejshme të ligjeve dhe rregulloreve, të drejta të tilla do të ushtrohen vetëm pas konsultimit me palën tjetër kontraktuese në përputhje me nenin 15 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5 **Përfashtime nga doganat, detyrimet dhe taksat e tjera**

1. Avionët që operojnë në shërbimet ajrore ndërkombëtare nga shoqëritë ajrore të secilës palë kontraktuese, si dhe pajisjet e tyre të rregullta, të furnizimit me karburante dhe lubrifikante, dhe rezervat në avion (ushqimet, pijet dhe cigaret) në bord, të tillë avionë do të përjashtohen nga të gjitha detyrimet doganore, pagesat e inspektimeve dhe të tjera detyrime ose taksa më mbërritjen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, më kusht që këto pajisje dhe rezerva të mbeten në bordin e avionit deri në kohën kur ato do të rieksporthen ose janë përdorur në bordin e avionit në pjesën e udhëtimit për t'u kryer mbi atë territor.

2. Gjithashtu, do të përjashtohen nga të njëjtat detyrime dhe taksa më përjashtim të mbartjes korresponduese të shërbimit të kryer:

a) rezervat e avionit të mbajtura në bord, në territorin e njërës palë kontraktuese, brenda

limiteve të fiksuara nga autoritetet e palës kontraktuese në fjalë dhe për përdorimin në bord të avionit të angazhuar në një shërbim ndërkombëtar të palës kontraktuese;

b) pjesët e këmbimit, të futura brenda territorit të njëres palë kontraktuese për mirëmbajtjeje ose riparim të avionit të përdorur në shërbimin ndërkombëtar nga një shoqëri ajrore e emëruar nga pala tjetër kontraktuese;

c) karburanti dhe lubrifikantët, të destinuara për furnizimin e avionit që operon në shërbime ndërkombëtare të shoqërive ajrore të emëruara nga pala tjetër kontraktuese, madje dhe kur këto furnizime do të përdoren në një pjesë të udhëtimit që do të kryhet mbi territorin e palës kontraktuese në të cilën ato mbahen në bord.

Materialet e referuara në nënparagrafët a, b dhe c të sipërpërmendura mund të kërkojnë të mbahen nën mbikëqyrjen e doganave ose kontrollit.

3. Pajisjet e rregullta të ngritjes së avionit në ajër, si dhe materialet dhe furnizimet e mbetura në bordin e avionit të njëres palë kontraktuese mund të shkarkohen në territorin e palës tjetër kontraktuese vetëm me miratimin e autoriteteve doganore të atij territori. Në të tilla kushte, ato mund të zëvendësohen nën mbikëqyrjen e autoriteteve në fjalë deri në kohën kur ato do të rieksporthohen ose ndryshe të jenë në dispozicion në përputhje me rregullat doganore.

4. Pasagjerët transit nëpërmjet territorit të njëres palë kontraktuese do të jenë subjekt të jo me shumë së një kontrolli të thjeshtë të vërtetë. Bagazhet dhe mallrat në transitin direkt do të përjashtohen nga dogana, detyrimet dhe taksat e tjera të thjeshta.

Neni 6 **Përfaqësimi**

1. Shoqëria ajrore e emëruar ose shoqëritë ajrore të njëres palë kontraktuese do të lejohen mbi bazën e reciprocitetit të mbajnë në territorin e palës tjetër kontraktuese përfaqësuesit e tyre dhe ata tregtarë stafin operacional dhe teknik të kërkuar në lidhje me operimin e shërbimeve të pranuar. Ky staf do të zgjidhet midis shtetasve të njëres ose të dyja palëve si të jetë e nevojshme.

2. Çdo palë kontraktuese do të lejojë shoqërinë ajrore të emëruar të palës tjetër kontraktuese të sjellë dhe të mbajë në territorin e palës tjetër kontraktuese punonjës dhe personel tjetër përgjegjës për administrimin, operimet teknike dhe tregtare të shërbimeve të tyre ajrore në përputhje me hyrjen, rezidencën dhe rregullat e punësimit dhe rregulloret e palës tjetër kontraktuese.

Neni 7 **Njohja e certifikatave dhe licencave**

Certifikatat e vlefshmërisë ajrore, certifikatat e kompetencës dhe licencat e lëshuara ose të bëra të vlefshme nga një palë kontraktuese dhe që janë akoma në fuqi do të njihen si të vlefshme nga pala tjetër kontraktuese për qëllimin e operimit të rrugëve dhe shërbimeve të dhëna për këtë Marrëveshje, me kusht që kërkesat sipas të cilave këto certifikata ose licenca të jenë lëshuar ose të bëra të vlefshme janë të barabarta tek ose mbi minimumin e standardeve, të cilat janë ose mund të vendosen në përputhje me Konventën. Megjithatë, çdo palë kontraktuese rezervon të drejtën të refuzojë njohjen, për qëllim të fluturimit mbi territorin e tij, certifikatat e kompetencës dhe licencat e dhëna shtetasve të tij ose të bëra të vlefshme për ta nga pala tjetër kontraktuese ose nga çdo shtet tjetër.

Neni 8 **Transferimi i fitimeve**

1. Çdo shoqëri ajrore e emëruar do të ketë të drejtën të shesë dhe të lëshojë dokumentet e saj të transportit në territorin e palës tjetër kontraktuese në mënyrë direkte dhe me vullnetin e saj, nëpërmjet agjentëve të tij. Të tilla shoqëri ajrore do të kenë të drejtën të shesin transportime të tilla dhe çdo person do të jetë i lirë të blejë transportime të tilla në çdo valutë të konvertueshme.

2. Çdo shoqëri ajrore e emëruar do të ketë të drejtën të konvertojë dhe të dërgojë në vendin e saj, me kërkesë, me shkallën zyrtare të këmbimit, shtesat e faturave mbi shpenzimet e

arritura në lidhje me mbartjen e trafikut. Në mungesë të parashikimeve përkatëse të pagesave të rëna dakord ndërmjet palëve kontraktuese, transfertat e sipërpërmendura do të bëhen në valutë të konvertueshme dhe në përputhje me ligjet e vendit dhe me rregullat e shkëmbimeve të huaja të aplikueshme dhe gjithashtu çdo shoqëri ajrore e emëruar do të ketë të drejtën të shesë, në valutën lokale, brenda territorit të palës tjetër kontraktuese.

Neni 9 **Ndarja e kodit**

Shoqëria(të) ajrore e emëruar e njërës nga palët kontraktuese mund të hyjë në rregullimin e ndarjes së kodit me:

- një shoqëri ajrore të njërës palë kontraktuese;
- një shoqëri ajrore e një vendi të tretë, për aq kohë sa autorizon ose lejon rregullime të krahasueshme ndërmjet shoqërive ajrore të palës kontraktuese dhe të tjera shoqëri ajrore në shërbim për dhe nga një vend të tillë të tretë.

Siguron së të gjitha shoqëritë ajrore në rregullimet e sipërpërmendura mbajnë rrugën përkatëse dhe të drejtat e trafikut.

Neni 10 **Parashikimet e kapacitetit**

1. Duhet të ekzistojë një mundësi e drejtë dhe e barabartë për shoqëritë ajrore të emëruara për të dyja palët kontraktuese që të operojnë shërbimet e pranuar në rrugë të specifikuar në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje ndërmjet territoreve respektive.

2. Duke operuar shërbimet e pranuar, shoqëritë ajrore të emëruara të çdo palë kontraktuese do të marrin në llogari interesat e shoqërive ajrore të emëruara të palës tjetër kontraktuese kështu për të mos prekur shërbimet, të cilat do të realizohen në të gjitha ose në një pjesë të të njëjtave rrugë.

3. Shërbimet e pranuar, të siguruar nga shoqëritë ajrore të emëruara nga palët kontraktuese do të mbajnë marrëdhënie të ngushta me kërkesat e transportit publik, në rrugët e specifikuar dhe do të kenë si objektiv parësor, parashikimin me një faktor të lartë dhe të arsyeshëm të kapacitetit adekuat, të zbatojë kërkesat aktuale dhe të arsyeshme për mbartjen e trafikut me origjinë ose me destinacion për territorin e palës kontraktuese e cila ka shoqëritë ajrore të emëruara.

4. Të drejtat e shoqërive ajrore të emëruara të njërës palë kontraktuese për të mbartur trafik ndërmjet pikave në territorin e palës tjetër kontraktuese dhe pikave në territoret e një vendi të tretë në rrugët e specifikuar, do të veprojnë në përputhje me parimet e përgjithshme në lidhje me kapacitetin:

a) kërkesat e trafikut për dhe nga territori i palës kontraktuese, e cila ka shoqërinë ajrore të emëruar;

b) kërkesat e trafikut në hapësirën përmes së cilës kalon shoqëria ajrore, pasi të ketë marrë në llogari shërbime të tjera transporti e vendosur nga shoqëria ajrore e shteteve që përfshin hapësirën;

c) kërkesat e operimeve nëpërmjet shoqërisë ajrore.

Çdo privilegj që do të jepet sipas paragrafit do të përcaktohet përfundimisht nga autoritetet aeronautike të Palëve Kontraktuese.

5. Kapaciteti që do të jepet dhe frekuenca e shërbimeve që do të operohen, do të vendosen ndërmjet autoriteteve aeronautike të palëve kontraktuese para së shërbimet të jenë inaguruar. Të tilla kapacitete dhe shërbime, të cilat do të përcaktohen fillimisht, mund të rishikohen dhe revizionohen nga koha në kohë nga autoriteti në fjalë.

Neni 11 **Sigurimi në aviacion**

1. Konsistent me të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas ligjit ndërkombëtar, palët

kontraktuese ripohojnë së detyrimet e tyre më njëri-tjetrin, për mbrojtjen e sigurisë së aviacionit civil kundër akteve të ndërhyrjeve të paligjshme, formojnë një pjesë të pandashme të kësaj Marrëveshjeje. Pa kufizuar të drejtat e tyre të përgjithshme dhe detyrimet sipas ligjit ndërkombëtar, palët kontraktuese, në veçanti, duhet të veprojnë në konformitet me parashikimet e Konventës mbi sulmet dhe disa akte të tjera të kryera në bord të avionit, nënshkruar në Tokio më 14 shtator 1963, Konventa për shtypjen e rrëmbimeve të paligjshme të avionit, nënshkruar në Hagë më 16 dhjetor 1970, Konventa për shtypjen e akteve të paligjshme kundër sigurisë së aviacionit nënshkruar në Montreal më 23 shtator 1971 ose çdo konventë tjetër në sigurimin e aviacionit në të cilën palët kontraktuese janë palë.

2. Palët kontraktuese do të sigurojnë, duke bërë kërkesë, të gjithë asistencën e nevojshme më njëri-tjetrin, për të parandaluar aktet e paligjshme të rrëmbimit të aviacionit civil dhe të tjera akte të paligjshme të sigurisë të avionëve të tillë, pasagjerët e tyre dhe ekuipazhin, aeroportet dhe mjetet ndihmëse të navigacionit dhe çdo kërcënim tjetër të sigurisë së aviacionit civil.

3. Palët në lidhjet e tyre të shumëanshme do të veprojnë në përputhje me dispozitat e sigurimit të aviacionit, të përcaktuara nga Organizata e Aviacionit Civil Ndërkombëtar dhe të përcaktuara sipas anekseve të Konventës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar duke i shtrirë këto parashikime në aplikimin nga palët; ato do të kërkojnë që operimet e avionit të regjistrove të tyre ose operimet e avionit, të cilat kanë vendet e tyre kryesore të biznesit ose të rezidencës së përhershme në territoret e tyre dhe operatorët e aeroporteve në territoret e tyre veprojnë në përputhje me parashikime të tilla të sigurimit të aviacionit.

4. Çdo Palë Kontraktuese bie dakord së operatorë të tillë të avionit mund të kërkojnë për të vëzhguar parashikimet e sigurimit të aviacionit të referuara në paragrafin (3) të mësipërm e kërkuar nga pala tjetër kontraktuese për hyrjen në, nisjen nga, ose brenda, në territorin e palës tjetër kontraktuese. Çdo palë kontraktuese do të sigurojë së masat adekuate janë efektiveisht të aplikuara brenda territorit të saj për të mbrojtur avionin dhe për të inspektuar pasagjerët, ekuipazhin, transportin e materialeve, bagazhet, mallra dhe rezervat e avionit para ose gjatë hipjes, ose ngarkimit. Çdo Palë Kontraktuese gjithashtu do të japë konsiderat pozitive për çdo ngarkesë nga pala tjetër kontraktuese për masat e sigurimit të veçantë, të arsyeshme për të takuar një kërcënim të veçantë.

5. Kur një aksident ose kërcënim i një aksidenti për kapjen e paligjshme të avionit civil ose akte të tjera të paligjshme kundër sigurisë së tillë të avionëve, pasagjerëve të tyre të ekuipazhit, aeroporteve ose mjeteve ndihmëse të navigacionit, palët kontraktuese do të ndikojnë në njëri-tjetrin më mjetet ndihmëse të komunikimit dhe masa të tjera të përshtatshme, që kanë për qëllim të përfundojnë shpejt dhe më siguri aksidente të tilla ose të kërcënimeve.

6. Nëse një palë kontraktuese ka probleme në lidhje me sigurinë në aviacion, parashikuar në këtë nen, autoritetet aeronautike të njëres palë kontraktuese mund të kërkojnë një konsultim të menjëhershëm me autoritetet aeronautike të palës tjetër kontraktuese.

Neni 12

Vendosja e tarifave

1.1 Tarifat, që do të aplikohen nga shoqëria ajrore e emëruar e një palë kontraktuese për shërbimet e mbuluara nga kjo Marrëveshje do të vendosen në nivele të arsyeshme, për pagesat e bëra për të gjithë faktorët përkatës, duke përfshirë interesat e përdoruesve, kostot e operimit, karakteristikat e shërbimeve, shkallën e komisionit, të përfitimit të arsyeshëm, tarifat e shoqërive të tjera ajrore dhe konsideratat e tjera tregtare në vendin e tregut.

1.2 Palët kontraktuese pranojnë të kenë kujdes të veçantë për tarifën, të cilat mund të jenë të kundërshtueshme sepse ato në mënyrë të paarsyeshme mund të jenë diskriminuese, shumë të larta ose të kufizuara për shkak të abuzimit të një pozicioni dominues, artificialisht e ulët për shkak të mospërkrahjes ose të përhapjes direkte ose indirekte ose të "lakmisë".

2. Tarifat, kur është e mundur, do të pranohen nga shoqëritë ajrore të emëruara në lidhje me të dyja palët kontraktuese, pas diskutimit, siç është kërkuar më qeveritë respektive dhe, në qoftë se është e aplikueshme, konsultimi me shoqëritë e tjera ajrore. Marrëveshje të tilla, kur është e mundur do të ndiqen nga përdorimi i mekanizmit të koodinimit të tarifave ndërkombëtare përkatëse. Në pamundësinë e përmblotjes së ndonjë marrëveshjeje shumëpalëshe, çdo shoqëri

ajrore e emëruar mund të zhvillojë tarifën në mënyrë individuale.

3.1 Çdo palë kontraktuese mund të kërkojë njoftim ose listën e tarifave të propozuara nga shoqëritë ajrore të emëruara të të dyja palëve kontraktuese për mbartjen tek ose nga territori i tij dhe, në rrethana të pranueshme, për transport nëpërmjet territorit të tij, kur një ndalesë është e lejuar në territorin e tij.

3.2 Njoftimi i tillë ose lista mund të kërkojë jo më shumë se para datës së propozuar për paraqitje. Në raste të veçanta kjo periudhë maksimale mund të zvogëlohet.

4.1 Asnjë palë kontraktuese nuk duhet të marrë veprime të njëanëshme për të parandaluar inaugurimin e tarifës së propozuar ose vazhdimësinë e një tarife efektive të një shoqërie ajrore të emëruar, ose të njëres prej palëve për mbartjen nëpërmjet territoreve të palëve.

4.2 Asnjë palë kontraktuese nuk duhet të ndërmarrë veprime të njëanëshme për të parandaluar inaugurimin e tarifës së propozuar ose vazhdimësinë e një tarife efektive të një shoqërie ajrore të emëruar ose të njëres palë për transportimin ndërmjet territorit të palës tjetër dhe atë të një shteti të tretë.

4.3 Për mbartjen ndërmjet territoreve të palëve kontraktuese, çdo palë do të lejojë shoqërinë(të) ajrore të palës tjetër për të shënuar çdo tarifë aktuale të autorizuar për aplikimin nga një shoqëri ajrore të njëres prej palëve ose të një shteti të tretë.

4.4 Për mbartjen ndërmjet territorit të njëres palë kontraktuese dhe atë të një shteti të tretë, pala kontraktuese do të lejojë shoqërinë(të) e palës tjetër për të shënuar çdo tarifë aktuale të autorizuar për aplikimin nga një shoqëri ajrore njëres prej palëve ose të një shteti të tretë.

4.5 Kur njëra prej palëve kontraktuese beson se tarifa bie brenda kategorive të përshkruara në paragrafit 1.2 të sipërpërmendur, të tilla palë do të japin njoftim për këtë mospëlqim tjetër (sa më shpejt të jetë e mundur dhe të paktën) brenda 15 ditëve të datës së njoftimit ose të listës së tarifës dhe mund të vlerësojë vetveten për procedurat e konsultuara të vendosura në paragrafin 5 si më poshtë, megjithatë në qoftë se të dyja palët kanë pranuar më shkrim për mosmiratim të tarifave në lidhje me këtë procedurë, tarifën do të konsiderohen të miratuara.

5. Çdo palë kontraktuese mund të kërkojë konsultim në lidhje me tarifën e një shoqërie ajrore të njëres palë për shërbimet e mbuluara nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë, ku tarifa përkatëse ka qenë subjekt i një njoftimi të mospranimit. Konsultime të tilla duhet të mbahen jo më vonë se 30 ditë nga marrja e kërkesës. Palët do të koepërojnë në sigurimin e informacionit të nevojshëm për zgjidhje të arsyeshme të çështjeve. Në qoftë se palët arrijnë Marrëveshjen me respektimin e tarifës për të cilën njoftimi i mospranimit, që është dhënë, çdo palë do të bëjë përpjekjet e saj për hyrjen e kësaj Marrëveshjeje në fuqi, por në qoftë se Marrëveshja nuk arrihet tarifa në fjalë do të hyjë ose do të vazhdojë të jetë në fuqi.

6. Tarifa e vendosur në përputhje me parashikimin e kësaj klauzole do të mbetet në fuqi, përderisa të tërhiqet nga shoqëria(të) ajrore përkatëse, për shkak të skadimit të datës së tarifës në qoftë se, ose derisa tarifën e reja do të jenë miratuar. Skadimi i datës origjinale mund të shtyhet derisa të dyja palët kontraktuese do të bien dakord se tarifa do të ndërpritet. Kur tarifa është miratuar pa ndonjë skadim të datës dhe, kur asnjë tarifë e re është vënë në listë dhe është miratuar, ajo tarifë do të mbetet në fuqi derisa të tërhiqet nga shoqëria(të) ajrore përkatëse ose të dyja palët kontraktuese bien dakord që tarifa nuk do të vazhdojë.

Neni 13

Siguria në aviacion

1. Çdo palë kontraktuese mund të kërkojë konsultime në çdo kohë në lidhje me standardet e sigurisë në çdo fushë, që lidhet me ekuipazhin ajror, me avionin ose operimet e tyre të adaptuara nga pala tjetër, të tilla konsultime do të zhvillohen brenda 30 ditëve të kërkesës së bërë.

2. Në qoftë se duke ndjekur konsultime të tilla, një palë zbulon se pala tjetër nuk mban në mënyrë efektive dhe administron standardet e sigurisë në ndonjë fushë të tillë, që janë më e pakta të barabartë me standardet minimum të vendosura në atë kohë në përputhje me Konventën e Çikagos, pala e parë do të njoftojë palën tjetër për këto probleme, hapat e konsideruara të nevojshme të jenë në konformitet me këto standarde minimale, Pala tjetër do të marrë masat e

përshtatshme korrekte. Mosveprimi nga pala tjetër për të marrë masat e përshtatshme brenda 15 ditëve ose një periudhe të tillë të gjatë siç është rënë dakord, kjo do të përbëjë bazën për aplikimin e nenit 4 të kësaj Marrëveshjeje (revokim, pezullim dhe ndryshim të autorizimit të operimit).

3. Pa paragjykuar detyrimet e përmendura në nenin 33 të Konventës së Çikagos, është rënë dakord së çdo avion, që operohet nga shoqëria ose shoqëritë ajrore të njëres palë për shërbimet për nga territori i palës tjetër, ndërsa është brenda territorit të palës tjetër, mund të bëhet subjekt i një shqyrtimin nga autoritetet respektive të Palës në bord dhe përreth avionit, mund të kontrollojë bashkë vlefshmërinë e dokumentacionit të avionit dhe ato të ekuipazhit të tij dhe kushtet e dukshme të avionit dhe të pajisjeve të tij (në këtë nen i quajtur inspektim i RAMP) siguron që kjo nuk të çon në një vonesë të paarsyeshme.

4. Në qoftë së një inspektim i tillë RAMP ose një seri inspektime RAMP tregon se:

a) një avion ose një operim i një avioni nuk vepron seriozisht më standardet minimum të vendosura në atë kohë në përputhje më Konventën e Çikagos; ose

b) ka mungesa serioze në mirëmbajtjen efektive dhe administrimin e standardeve të sigurisë të vendosura në atë kohë në përputhje më Konventën e Çikagos.

Pala duke zbatuar inspektimin, për qëllim të nenit 33 të Konventës së Çikagos, do të jetë e lirë për të konkluduar së kërkesat nën të cilën certifikata ose licenca në lidhje më këtë avion ose në lidhje më ekuipazhin e atij avioni janë lëshuar ose bërë të vlefshme, ose që kërkesat nën të cilën ai avion është duke operuar, nuk janë të barabarta ose mbi standardet minimum të vendosura në përputhje më Konventën e Çikagos.

5. Në rast të pranimin për qëllim të ndërmarrjes së një inspektimi të RAMP-it të një avioni, të operuar nga një shoqëri ose shoqëritë ajrore të njëres palë në përputhje më paragrafin 3 më sipër, është mohuar nga përfaqësuesi i asaj shoqërie ose shoqërive ajrore, pala tjetër do të jetë e lirë, për problemin serioz në lidhje më tipin e referuar në paragrafin 4, të dalë më konkluzione referuar në këtë paragraf.

6. Çdo palë rezervon të drejtën të pezullojë ose të ndryshojë menjëherë autorizimin e operimit të një shoqërie ose të shoqërive ajrore të palës tjetër në rast të konkludimit të palës së parë, ndërsa si rezultat i inspektimit të RAMP, të mohimit për një inspektim RAMP, konsultime ose përveç kësaj, një veprim i menjëhershëm është esencial për sigurimin për operimin e një shoqërie ajrore.

7. Çdo veprim i një palë në përputhje më paragrafin 2 dhe 6 nuk do të vazhdojë nëse veprimi pushon së ekzistuari.

Neni 14

Informacioni dhe statistik

Autoritetet aeronautike të njëres palë kontraktuese, duhet t'i japin autoriteteve aeronautike të palës tjetër kontraktuese, më kërkesën e tyre, statistika periodike ose të tjera, që mund të kërkojnë për rishikimin e kapaciteteve në shërbimet e miratuara nga shoqëritë ajrore të palës së parë kontraktuese. Këto statistika do të përfshijnë të gjithë informacionin e kërkuar, për të përcaktuar volumin e trafikut të kryer nga këto shoqëri në shërbimet e miratuara, si edhe origjinat dhe destinacionet e këtij trafiku.

Neni 15

Konsultimet dhe amendamentet

1. Në kuadrin e bashkëpunimit të ngushtë, autoritetet aeronautike të palëve kontraktuese do të konsultojnë njëra-tjetrën herë pas here për të siguruar zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, si dhe anekseve të saj.

2. Në qoftë së njëra palë kontraktuese konsideron të nevojshme të amendojë ndonjë nga parashikimet e kësaj Marrëveshjeje dhe të anekseve të saj, mund të kërkojë konsultime më palën tjetër kontraktuese, të tilla konsultime, të cilat mund të bëhen midis autoriteteve aeronautike, më anë të diskutimeve ose më korrespondencë, të cilat të fillojnë brenda një periudhë prej 60 ditësh

nga data e marrjes së kërkesës. Çdo amendament i rënë dakord në këtë mënyrë, do të hyjë në fuqi kur të jetë konfirmuar nga shkëmbimi i notave diplomatike.

3. Amendamentet për rrugët e rregullta në aneks mund të bëhen direkt më anë të një marrëveshjeje midis autoriteteve aeronautike të palëve kontraktuese.

Neni 16

Konformiteti më marrëveshje shumëpalëshe

Kjo Marrëveshje dhe anekset e saj do të amendohen në konformitet më ndonjë konventë shumëpalëshe, më të cilat do të jenë të lidhura të dyja palët kontraktuese.

Neni 17

Përfundimi

Secila palë kontraktuese në çdo kohë mund të japë njoftim të pala tjetër kontraktuese për vendimin e saj për të përfunduar këtë Marrëveshje.

Ky njoftim duhet, në të njëjtën kohë t'i komunikohet Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të përfundojë 12 muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga pala tjetër kontraktuese në qoftë së njoftimi nuk tërhiqet më marrëveshje përpara mbarimit të kësaj periudhe. Në mungesë të konfirmimit të marrjes nga pala tjetër kontraktuese, njoftimi do të konsiderohet, që është marrë 14 ditë pas marrjes së njoftimit nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil.

Neni 18

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Në qoftë së lind ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet palëve kontraktuese lidhur më interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe të anekseve të saj, palët kontraktuese fillimisht, duhen të përpiqen ta zgjidhin atë më bisedime ndërmjet tyre.

2. Në qoftë së palët kontraktuese nuk arrijnë ta zgjidhin atë më bisedime, ato mund të bien dakord ta referojnë mosmarrëveshjen për vendim tek një person ose bord, ose mosmarrëveshja mund, më kërkesë të njëres palë kontraktuese të paraqitet për zgjidhje në një gjykatë prej tre gjykatësish. Secila palë kontraktuese emëron nga një gjykatës, ndërsa i treti miratohet nga të dy gjykatësit e zgjedhur. Secila palë kontraktuese duhet të zgjedhë gjykatësin brenda një periudhe prej 60 ditësh nga data e marrjes së një note diplomatike nga pala tjetër kontraktuese ku kërkohet gjykimi i mosmarrëveshjes dhe gjykatësi i tretë do të miratohet brenda një periudhe tjetër prej 60 ditësh. Në qoftë së secila palë kontraktuese nuk e emëron gjykatësin e saj brenda një periudhe të specifikuar ose në qoftë së gjykatësi i tretë nuk miratohet brenda periudhës në fjalë, Presidenti i Këshillit të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil mund të kërkojë nga secila palë kontraktuese, që të caktojë një gjykatës ose gjykatësit sipas rastit të kërkuar.

Në këtë rast, gjykatësi i tretë do të emërohet nga një shtet i tretë dhe do të veprojë si president i gjykatës së arbitrit.

3. Palët kontraktuese zotohen që të zbatojnë çdo vendim të dhënë sipas paragrafit 2 të këtij neni.

4. Për aq kohë sa një palë kontraktuese, ose shoqëria ajrore e emëruar e një palë kontraktuese nuk zbaton vendimin e dhënë sipas paragrafit 2 të këtij neni, pala tjetër kontraktuese mund të kufizojë, pezullojë ose të revokojë ndonjë të drejtë ose privilegj, të cilin e ka dhënë në lidhje më këtë Marrëveshje tek pala tjetër kontraktuese moszbatuese.

5. Çdo palë kontraktuese duhet të paguajë shpenzimet e arbitrit që ajo ka emëruar. Shpenzimet e tjera të mbetura të gjykatës së arbitrit, duhet të ndahen në mënyrë të barabartë nga palët kontraktuese.

Neni 19
Titujt

Titujt janë vendosur në këtë Marrëveshje për qëllim të referimit dhe të lehtësisë dhe në asnjë mënyrë nuk përcaktojnë limite ose të përshkruajnë qëllimin ose për qëllim të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 20
Regjistrimi

Kjo Marrëveshje, anekset e saj dhe çdo amendament do të regjistrohen në Organizatën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar.

Neni 21
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje dhe anekset e saj, të cilat përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje, do të hyjnë në fuqi pas plotësimit të kërkesave konstitucionale prej secilës palë kontraktuese, në datën e këmbimit të notave diplomatike për këtë qëllim.

Dëshmohet se, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar nga qeveritë e tyre respektive, të kenë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Kjo Marrëveshje përfundon efektet e Marrëveshjes së shërbimeve ajrore dypalëshe ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë, nënshkruar më 13 shkurt 1984 në Tiranë.

Bërë në.....ditën eviti.....në dy kopje, në gjuhën angleze.

ANEKSI I
RRUGËT

1(a) Shoqëria ajrore e emëruar nga Republika e Shqipërisë ka të drejtë të operojë shërbimet ajrore në të dy drejtimet si më poshtë:

Nga	pikat e ndërmjetme	Tek	pikat e përtejme
Pikat në Shqipëri		Stamboll	

1.(b) Shoqëria ajrore e emëruar nga Republika e Turqisë ka të drejtë të operojë shërbimet ajrore në të dy drejtimet si më poshtë:

Nga	pikat e ndërmjetme	Tek	pikat e përtejme
Pikat në Turqi		Tirana	

2. Pikat në rrugët e mësipërme mund, që nga shoqëritë ajrore të shmangen në një ose në të gjitha fluturimet, më kusht që këto shërbime të kenë pikën e fillimit të tyre në territorin e Palës Kontraktuese, që ka emëruar shoqërinë ajrore.

3. Një nga palët kontraktuese më kërkesë mund të fusë në shërbimet e tyre pika shtesë, përtej territorit të një palë kontraktuese ose nëpërmjet territoreve të palëve kontraktuese. Kjo kërkesë është subjekt i miratimit të autoriteteve aeronautike të palës tjetër kontraktuese.

ANEKSI II
MIRATIMI I FLUTURIMEVE TË RREGULLTA

1. Shoqëria ajrore e një palë kontraktuese duhet të dorëzojë planin e fluturimeve të rregullta, përfshi tipin e pajisjes, për miratim tek autoritetet aeronautike të palës tjetër kontraktuese për secilën periudhë të rregullt (verore dhe dimërore) jo më vonë së 30 ditë para datës së hyrjes në fuqi të fluturimeve të rregullta. Në raste të veçanta kjo kohë limit mund të reduktohet si subjekt i pëlqimit të autoriteteve të përmendura.

2. Para dorëzimit të planit të fluturimeve të rregullta nga shoqëria ajrore e emëruar e një palë kontraktuese tek autoritetet aeronautike të palës tjetër kontraktuese, shoqëritë ajrore të të dyja palëve kontraktuese, duhet të bëjnë konsultime me njëra-tjetrën mbi planin e fluturimeve të rregullta, me qëllim lehtësimin e miratimit të tyre.

3. Autoritetet aeronautike më marrjen e planit të fluturimeve të rregullta mund t'i miratojnë ato ose të sugjerojnë modifikime. Në çdo rast shoqëritë ajrore të emëruara nuk duhet të fillojnë shërbimet e tyre para së të miratohet plani i fluturimeve të rregullta nga autoritetet përkatëse. Ky parashikim mund të aplikohet më ndryshime të mëvonshme.

LIGJ
Nr.9284, datë 30.9.2004

PËR PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, më propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton rrethin e personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar, si dhe kompetencat dhe kriteret për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive që lidhen me këto krime.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar nëpërmjet zbulimit, identifikimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të paligjshme të personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar, si dhe përcaktimi i mënyrës së përdorimit të këtyre pasurive.

Neni 3
Rrethi i personave të dyshuar

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen ndaj personave mbi të cilët ekziston një dyshim i

arsyeshëm, i bazuar në prova për:

a) pjesëmarrje në organizata kriminale ose në grupe të strukturuar kriminale, sipas parashikimeve të neneve 333 dhe 333/a të Kodit Penal dhe kryerjen e krimeve prej tyre;

b) pjesëmarrje në organizata terroriste ose në banda të armatosura, sipas parashikimeve të neneve 234/a dhe 234/b të Kodit Penal dhe kryerjen e krimeve prej tyre;

c) kryerjen e krimeve të tjera, për qëllime terroriste, të parashikuara në pjesën e posaçme, kreu VII i Kodit Penal;

ç) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 114/b, 128/b, 278/a, 282/a, 283/a e 284/a të Kodit Penal.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj:

a) bashkëshortit;

b) fëmijëve;

c) personave gjini ose krushqi e afërt më personin e dyshuar (të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, ungjërit, emta, nipërit, mbesat, fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, vjehrrit, vjehrra, dhëndri, nusja, kunata, thjeshtri, thjeshtra, njerku dhe njerka);

ç) personave fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme së pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga personat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e paligjshme të personave të dyshuar, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 4

Objekt i hetimeve

1. Ndaj personave të parashikuar në nenin 3 të këtij ligji kryhen hetime për mjetet financiare, pasuritë, veprimtaritë ekonomike, mënyrën e jetesës, si dhe për burimet e të ardhurave të tyre.

2. Hetimet bëhen, në veçanti, për të verifikuar nëse këta persona janë zotërues të lejeve, licencave, autorizimeve, koncesioneve dhe të drejtave të tjera për të ushtruar veprimtari ekonomike, tregtare dhe profesionale, si dhe për të verifikuar nëse ata përfitojnë kontribute, financime ose kreditime të çdo lloji, të dhëna apo të përfituara nga shteti, ente a persona juridikë publikë, organizma ose institucione ndërkombëtare.

3. Hetimet dhe gjykimet, sipas këtij ligji, mbështeten në rregullat procedurale civile dhe administrative në fuqi, përveç atyre të parashikuara dhe të referuara shprehimisht në këtë ligj.

KREU II

VERIFIKIMET PARAPRAKE

Neni 5

Kompetenca për verifikimet paraprake

Prokurori kryen veprime vetë dhe nëpërmjet Policisë Gjyqësore për hetimin e mjeteve financiare, të pasurive, veprimtarive ekonomike, mënyrës së jetesës, si dhe burimeve të të ardhurave të personave të dyshuar.

Neni 6

Detyrimi i dorëzimit të informacionit dhe të dokumenteve

1. Prokurori, drejtpërdrejt ose nëpërmjet Policisë Gjyqësore, mund të kërkojë pranë çdo zyre të administratës shtetërore, enti a personi juridik publik, personave të tjerë fizikë dhe juridikë, të dhëna dhe kopje të dokumenteve, që vlerësohen si të domosdoshme për qëllime hetimi ndaj personave të parashikuar në nenin 3 të këtij ligji.

2. Mbështetur në autorizimin e lëshuar nga prokurori ose gjykata, oficerët e Policisë Gjyqësore mund të vendosin sekuestrimin e dokumenteve të shqyrtuara, sipas rregullave të parashikuara në nenet 208, 209, 210 dhe 211 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 7 **Sekuestrimi paraprak**

1. Kur ekziston një rrezik real dhe konkret për humbjen, përvetësimin ose tjetërsimin e fondeve, të pasurive dhe të të drejtave të tjera, për të cilat parashikohet zbatimi i masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji, prokurori mund t'i kërkojë gjykatës të vendosë paraprakisht sekuestron e tyre, edhe përpara caktimit të datës së seancës gjyqësore.

2. Kërkesa e prokurorit për sekuestrimin paraprak shqyrtohet nga gjykata në praninë e tij, jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e kërkesës.

3. Në gjykimin e çështjes, gjykata mban parasysh kushtet dhe procedurat e zbatueshme, sipas neneve 16 dhe 26 të këtij ligji.

4. Masa e sekuestros është e vlefshme për një periudhë gjashtëmuajore, duke filluar nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.

5. Në rastin e hetimeve të ndërlikuara, më kërkesën e prokurorit, gjykata mund të vendosë zgjatjen e afatit të zbatimit të masës së sekuestros për periudha tremujore, por jo më shumë se një vit nga data e mbarimit të afatit të masës së sekuestros, të shpallur sipas pikës 4 të këtij neni.

Neni 8 **Shtrirja e hetimit në subjekte të kërcënuara nga organizatat kriminale**

Kur ka të dhëna të mjaftueshme për të gjykuar së zotërimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive ekonomike të caktuara gjendet në kushte kërcënimi ose ndikimi nga organizata kriminale apo në kushte të tilla që mund të lehtësojnë veprimtarinë e personave të dyshuar sipas këtij ligji, prokurori i kërkon gjykatës ta detyrojë personin, që ka titullin e pronarit ose zotëron çfarëdo titulli, fonde apo pasuri të çdo lloji, më vlerë që nuk përputhet më të ardhurat ose aftësitë e tij ekonomike, që të justifikojë ligjshmërinë e prejardhjes së tyre.

Neni 9 **Pezullimi i përkohshëm i administrimit dhe i disponimit të pasurive**

1. Kur ka të dhëna të mjaftueshme për të gjykuar së disponimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive ekonomike të përcaktuara në nenin 8 lehtëson veprimtarinë e personave të dyshuar sipas këtij ligji ose të personave ndaj të cilëve ka filluar procedimi penal për njërin nga krimet e parashikuara nga nenet 109, 109/b, 110/a, 114/b, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a, 284/a, 284/c, 284/ç, 287, 333, 333/a dhe nga kreu VII i Kodit Penal, gjykata, më kërkesë të prokurorit, vendos pezullimin e përkohshëm të administrimit dhe zotërimit të veprimtarive dhe të pasurive që përdoren, drejtpërdrejt ose jo, për kryerjen e këtyre veprimtarive ekonomike.

2. Pezullimi i përkohshëm i administrimit dhe i disponimit të veprimtarive e pasurive vendoset për një periudhë jo më të gjatë se gjashtë muaj dhe, më kërkesë të prokurorit, mund të vendosen zgjatje të mëtejshme të afatit për një periudhë tjetër, jo më të gjatë se gjashtë muaj.

3. Në vendimin e dhënë sipas pikës 1, gjykata cakton edhe një a më shumë administratorë nga lista e ekspertëve të Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, duke respektuar, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat e këtij ligji.

4. Nëse në masën e pezullimit të përkohshëm të administrimit dhe disponimit përfshihen edhe pasuri të paluajtshme ose pasuri të regjistruara në regjistra publikë, administratori i emëruar bën njoftimin e kësaj mase në zyrat pranë të cilave mbahen këta regjistra brenda 15 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

Neni 10 **Sekuestrimi**

1. Kur ekziston rreziku real dhe konkret që veprimtaritë dhe pasuritë e përcaktuara në

nenin 9 të këtij ligji të humbasin, të përvetësohen ose të tjetërsohen, prokurori mund t'i kërkojë gjykatës të vendosë sekuestron, në përputhje me parashikimet e dispozitave të këtij ligji.

2. Masa e sekuestros vendoset për një afat të njëjtë me atë të caktuar për pezullimin e përkohshëm të administrimit dhe disponimit, sipas pikës 2 të nenit 9 të këtij ligji.

Neni 11

Vendimi i gjykatës kur mbaron afati i pezullimit dhe i sekuestros

Gjykata, jo më vonë se 10 ditë përpara datës së mbarimit të afatit të masës së pezullimit të përkohshëm të administrimit e disponimit dhe të sekuestros, sipas neneve 9 e 10 të këtij ligji, vendos:

- a) rivendosjen në afat të këtyre masave;
- b) konfiskimin e pasurive, kur ka arsye të bazuar së ato janë produkt i veprimtarive të paligjshme ose përbëjnë investim të tyre;
- c) revokimin e masës.

Neni 12

Vendimet e gjykatës kur revokohet masa e pezullimit dhe e sekuestros

1. më vendimin e revokimit të masës së pezullimit të përkohshëm të administrimit e disponimit dhe masës së sekuestros, gjykata mund të vendosë detyrimin ndaj pronarit të pasurisë apo personit që ka në përdorim ose administrim pasurinë, apo pjesë të saj, për të njoftuar, për një periudhë jo më pak se pesë vjet, në Policinë Tatimore, akte të zotërimit, blerjes ose pagesave të kryera, të pagesave të marra, detyrave profesionale, të administrimit ose kujdestarisë, si dhe akte ose kontrata të tjera, sipas llojit dhe vlerës së përcaktuar nga gjykata në varësi të pasurisë dhe të të ardhurave të personit, por jo për një vlerë më të vogël se 2 milionë lekë.

2. Njoftimet e parashikuara në pikën 1 bëhen brenda 10 ditëve nga përfundimi i aktit dhe, në çdo rast, brenda datës 31 janar të çdo viti, për aktet e kryera në vitin pararendës.

3. Personi që nuk respekton detyrimet e njoftimit, brenda afateve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet. Përveç dënimit me burgim vendoset edhe konfiskimi i sendeve të fituara dhe i pagesave të marra, për të cilat nuk është respektuar detyrimi i njoftimit.

KREU III

GJYKIMI I KËRKESËS PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE

Neni 13

Kriteret për sekuestrimin e pasurive

1. Gjykata, më kërkesë të prokurorit, duke parashtruar arsyet përkatëse, vendos sekuestron e pasurive, për të cilat ka të dhëna se mund të jenë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në zotërim të personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet sipas këtij ligji, kur:

- a) vlera e tyre rezulton të jetë në përmasa që nuk u përgjigjet të ardhurave të deklaruara ose veprimtarisë ekonomike të zhvilluar prej tij;
- b) në bazë të të dhënave të mjaftueshme, ka shkaqe të bazuara për të menduar se këto sende janë produkt i veprimtarive të paligjshme ose përbëjnë investim të tyre.

2. Prokurori mund t'i kërkojë gjykatës ta detyrojë personin, ndaj të cilit zhvillohen hetimet, ose ata që kanë titullin e pronarit apo zotërojnë çfarëdo titulli, fonde ose pasuri të çdo lloji, më vlerë që nuk përputhet me të ardhurat ose aftësitë e tyre ekonomike, që të justifikojnë ligjshmërinë e prejardhjes së tyre.

Neni 14

Kryerja e veprimeve të tjera hetimore

Gjykata, më kërkesë të prokurorit ose kryesisht, mund të kryejë veprime të tjera, përveç atyre të parashikuara në kreun II të këtij ligji.

Neni 15

Procedimi në mungesë të personit të dyshuar

Me kërkesë të prokurorit, gjykata mund të vendosë vazhdimin e procedimit dhe masën e sekuestros edhe në rastet kur personi i dyshuar, sipas nenit 3 të këtij ligji, nuk ka banim të njohur brenda vendit, është larguar jashtë vendit ose, më gjithë kërkimet e bëra, nuk gjendet.

Neni 16

Pasuritë e sekuestruara që u përkasin të tretëve

1. Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del së pasuritë e sekuestruara u përkasin personave të tretë, gjykata, edhe kryesisht, më vendim të arsyetuar, i thërret ata për të ndërhyrë në procesin që zhvillohet sipas këtij ligji.

2. Personi i tretë, brenda afatit që i caktohet nga gjykata, ka të drejtë të paraqesë në seancë pretendimet e veta, si dhe të kërkojë marrjen e të dhënave të tjera të nevojshme për vendimin e sekuestros.

Neni 17

Ekzekutimi i masës së sekuestros

Për ekzekutimin e masës së sekuestros, sipas këtij ligji, zbatohen mënyrat e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

Neni 18

Shpenzimet e sekuestrimit

1. Shpenzimet për sekuestrimin, sipas këtij ligji, parapaguhet nga shteti dhe kompensohen nga personi, ndaj të cilit zhvillohen hetimet, në rast së vendoset sekuestrimi i pasurisë.

2. Shpenzimet e parapaguara nga shteti nuk kompensohen, nëse gjykata nuk vendos masën e sekuestrimit të pasurisë.

KREU IV

ADMINISTRIMI I PASURISË SË SEKUESTRUAR

Neni 19

Administratori i pasurisë së sekuestruar

1. Në vendimin e sekuestrimit, sipas këtij ligji, gjykata cakton administratorin e pasurisë së sekuestruar.

2. Administratori zgjidhet nga radhët e personave të punësuar ose të autorizuar nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

3. Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, më kërkesë të administratorit, mund ta autorizojë atë që të kërkojë ndihmën e specialistëve ose të personave të tjerë, të cilët shpërblehen për punën e bërë.

Neni 20

Detyrat e administratorit

1. Administratori ka për detyrë të ruajë dhe të administrojë pasurinë e sekuestruar. Gjithashtu, ai ka për detyrë të rrisë, nëse është e mundur, vlerën e këtyre pasurive.

2. Gjikata, kryesisht ose më kërkesë të prokurorit, mund ta shkarkojë administratorin nga detyra, në çdo kohë, për shkak të paaftësisë së tij ose të mospërbushjes së detyrës.

Neni 21

Ndalime për administratorin

Përveç rasteve kur autorizohet paraprakisht nga gjykata, administratori nuk lejohet të marrë pjesë në gjykim, të marrë kredi, të nënshkruajë marrëveshje pajtimi, arbitrazhi, premtimi, dorëzanie, hipotekimi ose tjetërsimi të pasurisë së sekuestruar apo të kryejë veprime të tjera juridike administrimi jo të zakonshme.

Neni 22

Raportimet e administratorit

1. Brenda 15 ditëve nga emërimi i tij, administratori detyrohet t'i paraqesë gjykatës një raport të hollësishëm për elementet thelbësore të ekzistencës dhe gjendjes, në të cilën ndodhet pasuria e sekuestruar. Në vijim, sipas afateve të caktuara nga gjykata, administratori i paraqet asaj raporte periodike për administrimin e pasurisë së sekuestruar, të shoqëruara, nëse kërkohet, me dokumentacionin përkatës.

2. Administratori është i detyruar të njoftojë gjykatën edhe për pasuri të tjera, që mund të jenë objekt i masës së sekuestros, për ekzistencën e të cilave është vënë në dijeni gjatë administrimit.

3. Administratori detyrohet që raportet e përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij neni, t'ia dërgojë edhe prokurorit.

Neni 23

Përballimi i shpenzimeve të administrimit

1. Shpenzimet e nevojshme ose të dobishme për ruajtjen dhe administrimin e pasurisë së sekuestruar përballohen nga fondet e siguruar nga administratori, në çdo lloj cilësie a burimi të ligjshëm.

2. Nëse nëpërmjet administrimit të pasurisë së sekuestruar nuk përfitohen fonde të mjaftueshme për përballimin e shpenzimeve, sipas pikës 1 të këtij neni, ato parapaguhën nga shteti nëpërmjet Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

3. Në rastet e vendosjes së masës së konfiskimit të pasurisë, shpenzimet e përballuara për administrimin e kësaj pasurie nga administratori ose Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara përfshihen në llogaritë e administrimit të tyre. Nëse fondet e llogarive të administrimit nuk janë të mjaftueshme për të përballuar pagesën e këtyre shpenzimeve, ato paguhën pjesërisht ose plotësisht nga shteti, pa të drejtë kompensimi.

4. Kur gjykata vendos revokimin e masës së sekuestros, pronari i pasurisë detyrohet të kompensojë përfitimet që ka pasur pasuria e tij gjatë administrimit. Ai ka të drejtë të kërkojë kompensimin në masën e pakësimit të vlerës së pasurisë ose të dëmit që i është shkaktuar pasurisë.

KREU V

KONFISKIMI I PASURISË SË SEKUESTRUAR

Neni 24

Kërkesa për konfiskimin e pasurisë së sekuestruar

Masa e konfiskimit vendoset me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës arsyet ku bazohet kërkesa.

Neni 25

Vendimi i gjykatës për konfiskimin

1. Gjkata, brenda 3 muajve nga paraqitja e kërkesës, sipas nenit 24 të këtij ligji, vendos konfiskimin e pasurisë së sekuestruar, për të cilën nuk vërtetohet prejardhja e ligjshme.

2. Vendimi i gjykatës për konfiskim mund të shpallet në një afat të mëvonshëm, por jo më shumë se 12 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës. më kërkesë të prokurorit, gjykata mund të vendosë shtyrjen e këtij afati edhe për një periudhë tjetër njëvjeçare.

3. Në përcaktimin e afateve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, gjykata mban parasysh kohën e pezullimit të gjykimit.

Neni 26

Refuzimi i kërkesës për konfiskim

Gjykata, edhe kryesisht, vendos refuzimin e kërkesës për konfiskimin e pasurisë dhe revokon masën e sekuestrimit kur:

a) nuk ka të dhëna të mjaftueshme, që vërtetojnë pjesëmarrjen e personit të dyshuar në veprimtaritë kriminale, të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji;

b) rezulton së pasuria e sekuestruar ka prejardhje të ligjshme;

c) rezulton së pasuria e sekuestruar nuk është, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në zotërim të pjesshëm apo të plotë të personit të dyshuar.

Neni 27

Marrëdhëniet me procedimin penal

1. Masa e sekuestrimit ose e konfiskimit mund të vendoset edhe ndaj pasurive të sekuestruara në një procedim penal.

2. Zbatimi i masave të vendosura, sipas pikës 1 të këtij neni, pezullohet për të gjithë periudhën e zhvillimit të procedimit penal.

3. Masat e vendosura, sipas pikës 1 të këtij neni, shuhet kur vendoset konfiskimi i të njëjtave pasuri në procedimin penal.

KREU VI

ANKIMI

Neni 28

Ankimi kundër vendimeve të sekuestrimit ose të konfiskimit

1. Kundër vendimit të gjykatës për sekuestrimin e pasurisë ose konfiskimin e pasurisë së sekuestruar mund të bëhet ankimi në gjykatën e apelit, sipas afateve dhe kushteve të gjykimit, të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit.

2. Kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet ankimi në Gjykatën e Lartë brenda 30 ditëve nga data e dhënies së vendimit.

Neni 29

Ekzekutimi i vendimit të konfiskimit dhe revokimit të sekuestrimit

1. Vendimi i konfiskimit të pasurive të sekuestruara vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes së tij.

2. Vendimi i revokimit të masës së sekuestrimit të pasurisë vihet në ekzekutim 15 ditë pas njoftimit të palëve të interesuara.

KREU VII

PËRDORIMI I PASURIVE TË KONFISKUARA

Neni 30

Kalimi i pasurive të konfiskuara në favor të shtetit

1. Pasuritë e konfiskuara më vendim gjykate, sipas këtij ligji, kalojnë në favor të shtetit.

2. Vendimi i formës së prerë për konfiskimin e pasurive i dërgohet menjëherë Agjencisë

për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Neni 31

Kompetenca për mënyrën e përdorimit të pasurive të konfiskuara

1. Mënyra e përdorimit të pasurive të luajtshme, pasurive të paluajtshme dhe pasurive që shërbejnë në veprimtari ekonomike e tregtare vendoset nga Ministri i Financave, në bazë të raportit të vlerësimit tekniko-financiar, si dhe të mundësive të përdorimit të tyre, të përcaktuara nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, në përputhje me kriteret e neneve 33, 34 dhe 35 të këtij ligji, si dhe në këshillim paraprak, brenda 10 ditëve nga paraqitja e raportit të vlerësimit, më njësitë e qeverisjes vendore ku gjendet kjo pasuri e paluajtshme.

2. Raporti i vlerësimit tekniko-financiar i paraqitet Ministrit të Financave brenda 90 ditëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor të parashikuar në pikën 2 të nenit 30 të këtij ligji.

3. Ministri i Financave, më urdhër, përcakton mënyrën dhe kushtet e përdorimit të pasurive të paluajtshme të konfiskuara dhe nxjerr udhëzimet shoqëruese të përdorimit brenda 30 ditëve nga paraqitja e raportit të vlerësimit tekniko-financiar, por jo më vonë se 120 ditë nga data e njoftimit të vendimit gjyqësor të parashikuar në pikën 2 të nenit 30 të këtij ligji.

Neni 32

Detyrat e administratorit të pasurive të konfiskuara

Administratori i caktuar nga gjykata, gjatë fazës së sekuestrimit të pasurive, vazhdon ushtrimin e detyrave, në emër dhe për llogari të Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, për aq kohë sa nuk është zëvendësuar prej saj më një person tjetër.

Neni 33

Përdorimi i pasurive të luajtshme dhe i mjeteve monetare

Administratori kryen veprimet e nevojshme për të dorëzuar në llogaritë e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara fondet në mjete monetare:

a) të konfiskuara, që nuk do të përdoren për administrimin e pasurive të tjera të konfiskuara ose që nuk do të përdoren për dëmshpërblimin e viktimave të veprave penale të krimit të organizuar;

b) të përfituara nga shitja e pasurive të luajtshme, që nuk përdoren në veprimtarinë e personit juridik tregtar dhe të titujve, në vlerën neto, të përfituara nga shitja e pasurive për dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar. Nëse procedurat e shitjes janë antiekonomike, Ministri i Financave vendos transferimin e pronësisë pa pagesë ose shkatërrimin e pasurisë së konfiskuar nga administratori;

c) që përfitohen nga rimarrja e kredive personale, nëse procedura e rimarrjes së tyre është antiekonomike ose, kur pas verifikimeve të bëra nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, për aftësinë paguese të debitorit, rezulton se ai nuk ka aftësi paguese, kreditë personale anulohen nga Ministri i Financave.

Neni 34

Përdorimi i pasurive të paluajtshme

1. Pasuritë e paluajtshme të konfiskuara përdoren si më poshtë:

a) shiten për dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar;

b) kalojnë në administrim të organeve të sistemit të drejtësisë, të rendit publik dhe mbrojtjes civile, për përmbushjen e funksioneve të tyre ose për qëllime sociale;

c) kalojnë në pronësi të njërive të qeverisjes vendore, ku gjendet pasuria e paluajtshme,

për përmbushjen e funksioneve të tyre ose për qëllime sociale.

2. Institucioni qendror ose njësia e qeverisjes vendore, në rastet e përdorimit për qëllime sociale, mund ta administrojë drejtpërdrejt pasurinë e paluajtshme ose t'ua japë në përdorim, pa shpërblim, organizatave jofitimprurëse apo enteve të tjera publike, që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre rehabilitimin social, kulturor e shëndetësor të shtresave në nevojë, veçanërisht atyre të prekura apo të rrezikuara nga krimi, përfshirë organizatat dhe qendrat terapeutike, të riaftësimit dhe kurimit të përdoruesve të substancave narkotike, si dhe qendrat e asistencës dhe të rehabilitimit të viktimave të trafikut të qenieve njerëzore.

3. Institucioni qendror ose njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara ta përdorin pasurinë e paluajtshme sipas mënyrës së caktuar të përdorimit, brenda një viti nga kalimi në administrim apo pronësi.

4. Institucionet qendrore që kanë në administrim, si dhe njësitë vendore që kanë në pronësi pasuritë e paluajtshme të konfiskuara, çdo gjashtëmuor, i dërgojnë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara një raport të hollësishëm për gjendjen dhe mënyrën e përdorimit të pasurisë së paluajtshme.

Neni 35

Mënyra e përdorimit të pasurive dhe veprimtarive tregtare

1. Veprimtaritë tregtare dhe pasuritë e paluajtshme të konfiskuara, që janë të vendosura në veprimtarinë e personave juridikë tregtarë, kalojnë në pronësi të shtetit.

2. Mbështetur në vlerësimin tekniko-financiar të Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, kur rezultojnë parashikime të bazuara për vazhdimësinë ose ripërtëritjen e veprimtarisë tregtare dhe të pasurive, sipas pikës 1 të këtij neni, apo zgjidhje të mundshme që ofrojnë ruajtjen ose një nivel të kënaqshëm punësimi, ato administrohen dhe përdoren si më poshtë:

a) u jepen në përdorim më qira dhe në forma të tjera të përdorimit më shpërblim personave juridikë publikë ose privatë, kundrejt kushteve të caktuara në ngarkim të tyre;

b) i jepen në përdorim më qira dhe në forma të tjera të përdorimit më shpërblim bashkësisë së punonjësve të personit juridik, veprimtaria e të cilit është konfiskuar, pa kushte të caktuara për përfituesin. Nuk lejohet dhënia në përdorim më qira bashkësive të punonjësve të personit juridik të konfiskuar, nëse anëtarë të saj janë bashkëshortja, të afërmit, krushqia ose bashkëjetuesja/i më personin ndaj të cilit është zbatuar masa e konfiskimit;

c) u shiten subjekteve që kanë paraqitur kërkesë, më një çmim jo më të ulët se vlerësimi i përcaktuar nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Shitja vendoset kur një zgjidhje e tillë ofron më shumë përparësi më interes publik ose kur të ardhurat e kësaj shitjeje do të përdoren për dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar. Në rastet kur shitja bëhet në mbarim të afatit të kontratës së qirasë apo dhënies në përdorim më shpërblim, përkatësisht, qiramarrësi ose përdoruesi i tyre mund të ushtrojë të drejtën e parablerjes brenda 30 ditëve nga njoftimi i procedurës së shitjes, që bëhet nga Ministri i Financave;

ç) vendosen në likuidim, nëse një zgjidhje e tillë ofron më shumë përparësi më interes publik ose kur fondet që do të sigurohen nga likuidimi do të përdoren për dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar.

Neni 36

Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

1. Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është institucioni përgjegjës për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

2. Rregullat e hollësishme për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara caktohen nga Këshilli i Ministrave.

3. Rregullat e hollësishme për kriteret e vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në

përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 37

Komiteti Këshillues për Masat Kundër Krimit të Organizuar

1. Për bashkërendimin e veprimtarive në zbatim të këtij ligji, për vlerësimin e ecurisë së administrimit dhe përdorimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, për dhënien e mendimit për kërkesat për financim të projekteve nga Fondi i Posaçëm për Parandalimin e Kriminalitetit dhe Edukimin Ligjor, si dhe për çështje të tjera që lidhen me parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, pranë Këshillit të Ministrave ngrihet dhe funksionon Komiteti Këshillues për Masat Kundër Krimit të Organizuar.

2. Komiteti thirret nga Kryeministri dhe në të marrin pjesë titullarët e institucioneve përgjegjëse për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, që janë në varësi të Këshillit të Ministrave, Prokurori i Përgjithshëm, Kryetari i Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, Kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, si dhe drejtuesit e shoqatave kombëtare të bashkive dhe komunave.

3. Në veprimtaritë e Komitetit mund të ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues nga institucione publike ose organizata të tjera, vendase a të huaja, veprimtarë në fusha me interes për zbatimin e këtij ligji.

4. Komiteti mblidhet së paku një herë në 3 muaj. Komiteti, më propozimin e Kryeministrit, miraton rregullat e hollësishme për funksionimin e tij.

Neni 38

Raportimi periodik në Këshillin e Ministrave

Ministri i Financave, në përfundim të çdo viti financiar, i paraqet Këshillit të Ministrave raportin për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara sipas këtij ligji.

Neni 39

Fondi i Posaçëm për Parandalimin e Kriminalitetit dhe Edukimin Ligjor

1. Për një periudhë pesëvjeçare, duke filluar nga viti financiar 2005, 50 për qind e të ardhurave në Buxhetin e Shtetit, të përfituara sipas neneve 33 e 35 të këtij ligji, do të përdoren për ngritjen e Fondit të Posaçëm për Parandalimin e Kriminalitetit dhe Edukimin Ligjor.

2. Ky Fond do të shërbejë për mbështetjen financiare të projekteve, që synojnë administrimin për qëllime institucionale, sociale ose për interes publik të pasurive të paluajtshme të konfiskuara, si dhe për projekte konkrete për:

a) riaftësimin dhe kurimin e përdoruesve të substancave narkotike, si dhe asistencën e rehabilitimitin e viktimave të trafikut të qenieve njerëzore;

b) përmirësimin e infrastrukturës, të shërbimeve dhe jetesës në zona me probleme sociale;

c) zhvillimin e veprimtarive dhe të programeve shkollore për edukimin ligjor;

ç) nxitjen dhe zhvillimin e edukatës së punës të brezi i ri dhe, në veçanti, të personat e papunë ose që jetojnë në zona me probleme sociale.

3. Përveç institucioneve qendrore, përfitues të financimit të projekteve, sipas pikës 2 këtij neni, mund të jenë:

a) njësitë e qeverisjes vendore, ku ndodhen pasuritë e paluajtshme të konfiskuara;

b) organizatat jofitimprurëse ose entet e tjera publike, që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre rehabilitimin social, kulturor e shëndetësor të shtresave në nevojë, veçanërisht atyre të prekur apo të rrezikuar nga krimi, përfshirë organizatat dhe qendrat terapeutike, qendrat e riaftësimit dhe të kurimit të përdoruesve të substancave narkotike, si dhe qendrat e asistencës dhe të rehabilitimit të viktimave të trafikut të qenieve njerëzore, që në tre vitet e fundit nga paraqitja e kërkesës zhvillojnë veprimtari të tilla.

4. Kërkesat për financimin e projekteve, sipas këtij neni, verifikimi dhe përgatitja e dokumentacionit për mendim në Komitetin Këshillues për Masat Kundër Krimit të Organizuar, si

dhe ndjekja e zbatimit të tyre bëhen nga strukturat e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

5. Ministri i Financave, mbështetur në mendimin e Komitetit Këshillues për Masat Kundër Krimit të Organizuar, më urdhër, përcakton financimin e projektit dhe mënyrat e përdorimit të fondit të vënë në dispozicion të kërkuarit.

Neni 40

Dispozitë kalimtare

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikave 2 e 3 të nenit 36 të këtij ligji.

2. Deri në ditën e fillimit të veprimtarisë së Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, funksionet e saj ushtrohen nga strukturat e Ministrisë së Financave.

Neni 41

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur më dekretin nr.4371, datë 26.10.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ

Nr.9285, datë 30.9.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8977, DATË 12.12.2002 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, më propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Në pikën 24 të nenit 5, taksa për kazinotë nga “30 000 000 lekë” ndryshon në “1 000 000 000 (një miliard lekë)”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur më dekretin nr.4372, datë 26.10.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ

Nr.9286, datë 30.9.2004

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË LIGJIN NR.8975, DATË 21.11.2002 “PËR TRAJTIMIN E FATURAVE TATIMORE TË UJIT TË PIJSHËM SI TITULL

EKZEKUTIV”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, më propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”, bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

Neni 1

Titulli i ligjit ndryshohet si më poshtë:

“Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm dhe të largimit të ujërave të përdorura si titull ekzekutiv”.

Neni 2

Në nenin 1, pas fjalëve “të ujit të pijshëm”, shtohen fjalët “dhe largimit të ujërave të përdorura”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur më dekretin nr.4373, datë 26.10.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ Nr.9287, datë 7.10.2004

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT SHITESË TË KONVENTËS “PËR MBROJTJEN E INDIVIDËVE NË LIDHJE MË PËRPUNIMIN AUTOMATIK TË TË DHËNAVE PERSONALE NGA ORGANET MBIKËQYRËSE DHE FLUKSI NDËRKUFITAR I TË DHËNAVE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, më propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Protokollin shtesë i Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale nga organet mbikëqyrëse dhe fluksi ndërkufitar i të dhënave”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur më dekretin nr.4374, datë 26.10.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

PROTOKOLL SHITESË

**I KONVENTËS MBI MBROJTJEN E INDIVIDËVE NË LIDHJE MË PËRPUNIMIN
AUTOMATIK TË TË DHËNAVE PERSONALE NGA ORGANET MBIKËQYRËSE DHE
FLUKSI NDËRKUFITAR I TË DHËNAVE**

Strasbourg, 8.11.2001

Preambul

Palët në këtë protokoll shtesë të Konventës për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale të hapur për nënshkrim në Strasbourg më 28 janar 1981 (tani e tutje referenca është “Konventa”),

të bindur së organet mbikëqyrëse, në ushtrim të funksioneve të tyre në pavarësi të plotë, janë një element i mbrojtjes së efektshme në lidhje me përpunimin e të dhënave personale,

duke pasur parasysh rëndësinë e fluksit të informacionit ndërmjet njerëzve,

duke pasur parasysh se, më rritjen e shkëmbimeve të të dhënave personale tej kufijve kombëtare, është e nevojshme të sigurohet mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe, sidomos e drejta e jetës private, në lidhje me këto këmbime të të dhënave personale,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Organet mbikëqyrëse

1. Çdo palë siguron që një ose më shumë organe janë kompetente për të arritur përputhjen me masat në ligjin e brendshëm duke i bërë të efektshme parimet e përcaktuara në kapitujt II dhe III të Konventës dhe të këtij protokollit.

2.a Për këtë qëllim, këto organe kanë kompetencën e hetimit dhe ndërhyrjes, si dhe kompetencën për t'u përfshirë në procese gjyqësore për të sjellë në vëmendjen e organeve kompetente gjyqësore shkeljet e dispozitave të ligjit të brendshëm, duke bërë kështu të efektshme parimet e përmendura në paragrafin 1 të nenit 1 të këtij protokollit.

2.b Çdo organ mbikëqyrës dëgjon pretendimet e paraqitura nga çdo person në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të tij/saj dhe lirive themelore në lidhje me përpunimin e të dhënave personale brenda kompetencës së tij.

3. Organet mbikëqyrëse i ushtrojnë funksionet e tyre në pavarësi të plotë.

4. Vendimet e organeve mbikëqyrëse, kundër të cilave ka ankesa, mund të apelojnë në gjykatë.

5. Në pajtim me dispozitat e kapitullit IV dhe pa cenuar dispozitat e nenit 13 të Konventës, organet mbikëqyrëse bashkëpunojnë me njëra-tjetrën deri në masën që është e nevojshme për ushtrimin e detyrave të tyre, sidomos në shkëmbimin e të gjithë informacionit të nevojshëm.

Neni 2

**Fluksi ndërkufitar i të dhënave personale për tek një marrës që nuk i nënshtrohet
juridiksionit të një palë në Konventë**

1. Çdo palë siguron transferimin e të dhënave personale për tek një marrës që është nën juridiksionin e një shteti ose organizate që nuk është palë në Konventë vetëm kur shteti ose organizata garanton në një masë të kënaqshme sigurinë për transferimin e të dhënave që kërkohen.

2. Duke u shmangur nga paragrafi 1 i nenit 2 të këtij protokoll, secila palë mund të lejojë transferimin e të dhënave personale:

a) nëse ligji i brendshëm e parashikon këtë për shkak:

- të interesave të veçanta të subjektit të të dhënave, ose

- të interesave të ligjshme dhe të larta, sidomos të interesave të rëndësishme publike;

b) nëse jepen garanci, gjë që mund të lindë veçanërisht nga dispozitat kontraktuale, nga mbikëqyrësi përgjegjës për transferimin së këto konsiderohen të rëndësishme nga organet kompetente sipas ligjit të brendshëm.

Neni 3

Dispozita të fundit

1. Dispozitat e neneve 1 dhe 2 të këtij protokoll, konsiderohen nga palët si nene shtesë të Konventës dhe të gjitha dispozitat e Konventës zbatohen përkatësisht.

2. Ky protokoll është i hapur për nënshkrim nga shtetet palë të Konventës.

Pas anëtarësimit në Konventë, sipas kushteve të përcaktuara në të, Komuniteti Europian mund të nënshkruajë këtë protokoll. Ky protokoll i nënshtrohet ratifikimit, pranimi ose aprovimit. Një palë e këtij protokoll nuk mund ta ratifikojë, pranojë ose aprovojë atë, përveç kur ai ka ratifikuar, pranuar ose aprovuar më parë ose njëkohësisht Konventën ose është anëtarësuar në të. Instrumentet e ratifikimit, pranimi ose aprovimit të këtij protokoll depozitohen të Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

3.a Ky protokoll hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas përfundimit të periudhës tremujore pas datës në të cilën pesë shtetet palë të tij kanë shprehur pëlqimin për t'iu nënshtruar protokollit në pajtim me dispozitat e paragrafit 2 të nenit 3;

3.b Në lidhje me çdo shtet palë të këtij protokoll i cili e shpreh pëlqimin e tij më vonë për t'iu nënshtruar atij, protokoll hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimi ose aprovimit.

4.a Pas hyrjes në fuqi të këtij protokoll, çdo shtet që është anëtarësuar në Konventë mund të anëtarësohet në protokoll;

4.b Anëtarësimi kryhet nëpërmjet depozitimit të Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës të instrumentit të anëtarësimit, i cili bëhet i efektshëm në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit.

5.a Çdo palë mund ta denoncojë në çdo kohë këtë protokoll nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës;

5.b Një denoncim i tillë bëhet i efektshëm në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe tremujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

6. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Europës, Komunitetin Europian dhe çdo shtet tjetër që është anëtarësuar në këtë protokoll:

a) për çdo nënshkrim;

b) për depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimi ose aprovimit;

c) për çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij protokoll në pajtim me nenin 3;

d) për çdo akt, denoncim ose komunikim tjetër në lidhje me këtë protokoll.

Si dëshmi të kësaj të poshtëshënuarit, ligjërisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Strasburg, më 8 nëntor 2001 në anglisht dhe frëngjisht, të dyja tekstet njëlloj autentike, në një kopje të vetme e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës u transmeton kopje të vërtetuara të gjitha shteteve anëtare të Këshillit të Europës, Komunitetit Europian dhe çdo shtet i ftuar për t'iu anëtarësuar në Konventë.

LIGJ
Nr.9288, datë 7.10.2004

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS "PËR MBROJTJEN E INDIVIDËVE NË LIDHJE ME
PËRPUNIMIN AUTOMATIK TË TË DHËNAVE PERSONALE"**

Ne mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKES SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale", bërë në Strasburg, më 28.1.1981.

Neni 2

Ne përputhje me piken 2/a të nenit 3 të Konventës, Republika e Shqipërisë deklaron se nuk do ta zbatojë këtë Konventë për kategorinë e të dhënave personale:

- a) përpunimi i të cilave kryhet vetëm për qëllime individuale nga vetë individët, me kusht që këto të dhëna të mos përdoren për t'u shpërndarë nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit.
- b) që disponohen publikisht sipas ligjit, si dhe ato të dhëna, publikimi i të cilave behet më ligj.

Neni 3

Ne përputhje me piken 2/b të nenit 3 të Konventës, Republika e Shqipërisë deklaron se do ta zbatojë këtë konventë për të dhënat, që kane të bëjnë më grupe personash, shoqata, fondacione, shoqëri, institucione dhe ente të tjera, që përbëhen drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nga individë, pavarësisht nëse kane ose jo personalitet juridik.

Neni 4

Ne përputhje me paragrafin e dytë të nenit 13 të Konventës, Republika e Shqipërisë deklaron se organet e caktuara për bashkëpunim ndërmjet palëve janë:

- Ministria e Drejtësisë, më adrese: Bulevardi "Zogu I", nr.5, Tirane, Shqipëri.
- 2. Instituti i Statistikave (INSTAT), më adrese: Rruga "Leke Dukagjini", Tirane, Shqipëri.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 dite pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur më dekreten nr.4375, date 26.10.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

**KONVENTË
PËR MBROJTJEN E INDIVIDËVE NË LIDHJE MË PËRPUNIMIN AUTOMATIK TË
TË DHËNAVE PERSONALE**

Strasbourg 28.1.1981

Preambulë

Shtetet anëtarë të Këshillit të Europës, nënshkruese,
duke pasur parasysh se Këshilli i Europës është për të arritur një unitet më të madh
ndërmjet anëtarëve të tij, bazuar sidomos mbi respektimin e shtetit ligjor, si dhe të drejtat e njeriut
dhe lirive themelore,

duke pasur parasysh se është e dëshirueshme të zgjerohen garancitë për të drejtat e të
gjithëve dhe liritë themelore, dhe sidomos të drejtat për të respektuar jetën private, duke marrë
parasysh fluksin ndërkufitar në rritje të të dhënave personale që i nënshtrohen përpunimit
automatik,

duke riafirmuar në të njëjtën kohë përkushtimin e tyre për lirinë e informacionit
pavarësisht nga kufijtë,

duke njohur që është e nevojshme të përshtaten vlerat themelore për respektimin e jetës
private dhe fluksin e lirë të informacionit ndërmjet njerëzve,
kanë rënë dakord si më poshtë:

**KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

Qëllimi i kësaj Konvente është të sigurojë në territorin e çdo palë për të gjithë individët,
pavarësisht nga shtetësia ose vendbanimi i tyre, respekt për të drejtat e tyre dhe liritë themelore,
dhe në veçanti të drejtën e tyre për jetën private, në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave
personale që kanë të bëjnë me të (mbrojtja e të dhënave).

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) "Të dhënat personale" janë të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me një individ të
identifikuar ose të identifikueshëm;

b) "Dosje e të dhënave të autorizuar" janë të gjitha kompletet e të dhënave që i
nënshtrohen përpunimit automatik.

c) "Përpunimi automatik" përfshin operacionet e mëposhtme, nëse kryhen plotësisht ose
pjesërisht me anë të mjeteve automatike: ruajtja e të dhënave, kryerja e veprimeve logjike dhe/ose
aritmetike mbi këto të dhëna, ndryshimin, fshirjen, marrjen ose shpërndarjen e tyre;

d) "Kontrollor i dosjes" është çdo person fizik ose juridik, organ publik, agjenci ose
ndonjë autoritet tjetër që është kompetent në bazë të ligjit vendas për të vendosur së cili duhet të
jetë qëllimi i dosjes së të dhënave të automatizuara, cilat kategori të të dhënave personale duhet të
ruhen dhe cilat veprime duhet të zbatohen mbi to.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Palët marrin përsipër të zbatojnë këtë Konventë për dosjet e të dhënave personale të
automatizuara dhe për përpunimin automatik të të dhënave personale në sektorët publikë dhe
privatë.

2. Çdo shtet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit,

pranimit, aprovimit ose anëtarësimit, ose në një datë të mëvonshme, mund të bëjë të ditur nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Këshillit të Europës:

a) së ai nuk e zbaton këtë Konventë për kategori të caktuara të dosjeve për të dhënat personale të automatizuara, duke depozituar edhe një listë të tyre. Megjithatë në këtë listë nuk përfshihen kategoritë e dosjeve për të dhënat e automatizuara që në bazë të ligjit vendas u nënshtrohen dispozitave për mbrojtjen e të dhënave. Ai e ndryshon këtë listë përkatësisht nëpërmjet një deklarate të re, kurdoherë që kategori të tjera të dosjeve për të dhënat personale të automatizuara u nënshtrohen dispozitave për mbrojtjen e të dhënave në bazë të ligjit vendas;

b) së ai e zbaton këtë Konventë për informacionin që ka të bëjë me grupe personash, shoqata, fondacione, kompani, korporata ose institucione të tjera që përbëhen direkt ose indirekt nga individë, pavarësisht nëse këto institucione kanë ose jo personalitet juridik;

c) së ai e zbaton këtë Konventë për dosjet e të dhënave personale, të cilat nuk përpunohen automatikisht.

3. Çdo shtet i cili e ka zgjeruar fushën e zbatimit të kësaj Konvente më anë të deklarimeve të parashikuara në nënparagrafët 2. b ose c të mësipërm mund të bëjnë të ditur në këtë deklaram së këto zgjerime zbatohen vetëm për kategori të caktuara të dosjeve të të dhënave personale, duke depozituar edhe një liste të tyre.

4. Çdo palë, që ka përjashtuar kategori të caktuara të dosjeve për të dhënat personale të automatizuara nëpërmjet një deklarimi të parashikuar në nënparagrafin 2.a të mësipërm, nuk mund të pretendojë zbatimin e kësaj Konvente për këto kategori nga një palë që nuk ka bërë përjashtime të tilla.

5. Po kështu, një palë që nuk ka bërë ndonjë nga zgjerimet e parashikuara në nënparagrafin 2. b dhe c të mësipërm nuk mund të pretendojë zbatimin e kësaj Konvente për këto pika në lidhje me ndonjë palë që i ka bërë këto zgjerime.

6. Deklarimet e parashikuara në paragrafin 2 të mësipërm, bëhen të efektshme që nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në lidhje me shtetin që i ka bërë ata, kur këta janë bërë në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose anëtarësimit, ose tre muaj pas marrjes së tyre nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës, kur këto janë bërë në një datë të mëvonshme. Këto deklarime mund të tërhiqen, plotësisht ose pjesërisht, nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Këto tërheqje hyjnë në fuqi tre muaj pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë.

KAPITULLI II PARIMET THEMELORE TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE

Neni 4 Detyrat e Palëve

1. Secila palë merr masat e nevojshme në ligjin vendas për të bërë të efektshme parimet themelore për mbrojtjen e të dhënave të paraqitura në këtë kapitull.

2. Këto masa merren jo më vonë së në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në lidhje me palën përkatëse.

Neni 5 Cilësia e të dhënave

Të dhënat personale që i nënshtrohen përpunimit automatik janë:

- a) marrë dhe përpunuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme;
- b) ruajtur për qëllime specifike dhe të legjitimuara dhe që nuk përdoren në ndonjë mënyrë që nuk përputhen me këto qëllime;
- c) të përshtatshme, që përfshihen dhe jo të tepërta në lidhje me qëllimet për të cilat ato janë ruajtur;
- d) të sakta dhe, nëse është e nevojshme, mbahen aktuale;
- e) mbahen në një formë që i lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave për jo më

shumë nga sa kërkohet për qëllimet për të cilat janë ruajtur akoma këto të dhëna.

Neni 6

Kategori specifike të të dhënave

Të dhënat personale që tregojnë origjinën racore, bindjet politike, besimet fetare ose të tjera, si dhe të dhënat personale që kanë të bëjnë me shëndetin ose jetën seksuale, nuk mund të përpunohen automatikisht, përveç kur ligji vendos parashikim garanci të përshtatshme. E njëjta gjë zbatohet për të dhënat personale që kanë të bëjnë me fajësimet penale.

Neni 7

Siguria e të dhënave

Merren masa të përshtatshme sigurie për mbrojtjen e të dhënave personale të ruajtura në dosjet e të dhënave të automatizuara kundër prishjes së tyre aksidentale ose të paautorizuara ose të humbjes aksidentale, si dhe kundër hyrjes, ndryshimit dhe shpërndarjes së paautorizuara.

Neni 8

Garant shtesë për subjektin e të dhënave

Çdo personi i jepet mundësia:

a) të themelojë ekzistencën e një dosjeje me të dhëna personale të automatizuara, qëllimet e saj kryesore, si dhe identitetin dhe vendbanimin e zakonshëm ose vendin kryesor të punës së kontrollit të dosjes;

b) të marrë në intervale të arsyeshme dhe pa vonesë ose shpenzime të mëdha, konfirmimin nëse të dhënat personale që kanë të bëjnë me të janë ruajtur në një dosje me të dhëna të automatizuara, si dhe komunikimin tek ai të këtyre të dhënave në një formë të kuptueshme;

c) të beje, siç mund të jetë rasti, korrigjimin ose fshirjen e këtyre të dhënave nëse ato janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e ligjit vendos, të cilat bëjnë të efektshme parimet themelore të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të kësaj Konvente;

e) e një mjeti ligjor mbrojtjeje nëse nuk është përmbushur një kërkesë për konfirmim ose, sipas rastit, për komunikim, korrigjim ose fshirje të parashikuara në paragrafët b dhe c të këtij neni.

Neni 9

Përfundimet dhe kufizimet

1. Nuk lejohet asnjë përfundim për dispozitat e neneve 5, 6 dhe 8 të kësaj Konvente, përveç kur bëhet brenda kufijve të përcaktuar në këtë nen.

2. Devijimi nga dispozitat e neneve 5, 6 dhe 8 të kësaj Konvente lejohet vetëm kur një devijim i tillë është i parashikuar nga ligji i palës dhe përben një masë të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes:

a) të mbrojtjes së sigurisë së shtetit, sigurisë publike, dhe interesave monetare të shprehur ose të luftës kundër veprave penale;

b) të mbrojtjes së subjektit të të dhënave ose të drejtave dhe lirive të tjerëve.

3. Kufizimet në ushtrimin e të drejtave të parashikuara në nenin 8 paragrafi b, c dhe d, mund të parashikohen me ligj në lidhje me dosjet e të dhënave personale të automatizuara që përdoren për qëllime statistikore ose për kërkime shkencore kur duket se nuk ka ndonjë rrezik për cenimin e jetës private të subjekteve të të dhënave.

Neni 10

Sanksionet dhe mjetet e mbrojtjes

Çdo palë merr përsipër të caktojë sanksione të përshtatshme dhe mjete mbrojtjeje për

shkeljen e dispozitave të ligjit të brendshëm, duke bërë të efektshme parimet themelore për mbrojtjen e të dhënave të parashikuara në këtë kapitull.

Neni 11

Mbrojtja e gjere

Asnjë nga dispozitat e këtij kapitulli nuk interpretohet si për të kufizuar ose për të ndikuar në ndonjë mënyrë tjetër mundësinë e një palë për t'u siguruar subjekteve të të dhënave një masë më të gjerë së ajo e parashikuar në këtë Konvente.

KAPITULLI III

FLUKSI NDERKUFITAR I TË DHËNAVE

Neni 12

Fluksi ndërkufitar i të dhënave personale dhe ligji i brendshëm

1. Dispozitat e mëposhtme zbatohen për transferimin përtej kufijve shtetërore, më çfarëdolloj mjeti, i të dhënave personale që i nënshtrohen përpunimit të automatizuar, ose që mbliidhen më qëllimin e përpunimit të tyre në mënyrë të automatizuar.

2. Për qëllimin e vetëm të mbrojtjes së jetës private, një palë nuk e ndalon ose kushtëzon më autorizim të veçante flukset ndërkufitare të të dhënave personale që shkojnë në territorin e një palë tjetër.

3. Megjithatë, secila palë ka të drejtën e shmangies nga dispozitat e paragrafit 2:

a) nëse legjislacioni i saj përfshin rregulla specifike të kategorive të caktuara të të dhënave personale ose të dosjeve më të dhëna personale të automatizuara, për shkak të natyrës së këtyre të dhënave ose dosjeve, përveç kur rregullat e palës tjetër sigurojnë një mbrojtje identike;

b) kur transferimi behet nga territori i saj në territorin e një shteti joanetar, nëpërmjet ndërmjetësimit të territorit të një palë tjetër, më qellim që të evitohen të tilla transferime që rezultojnë në anashkalimin e legjislacionit të palës së përmendur në fillim të këtij kapitulli.

KAPITULLI IV

NDIHMA E NDERSJELLE

Neni 13

Bashkëpunimi ndërmjet palëve

1. Palët bien dakord t'i japin njëra-tjetrës ndihme të ndërsjelle, më qellim që të zbatohet kjo Konvente.

2. Për këtë qellim:

a) Çdo palë cakton një ose disa organe, emrin dhe adresën e të cilave ia komunikon Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës;

b) Çdo palë që ka caktuar më shume së një organ në komunikatën e saj që përmendet në nënparagrafin e mësipërm kompetencën e secilit organ.

3. Një organ i caktuar nga një palë, më kërkesë të një organi të caktuar nga një palë tjetër:

a) jep informacion në lidhje më ligjin e saj dhe praktikën administrative në fushën e mbrojtjes së të dhënave;

b) në pajtim më ligjin e brendshëm dhe për qëllimin e vetëm të mbrojtjes së jetës private, merr të gjitha masat për dhënien e informacionit faktik në lidhje më përpunimin specifik të automatizuar në territorin e saj, më përjashtim të të dhënave që janë në përpunim e sipër.

Neni 14

Ndihma për subjektet e të dhënave më banim jashtë shtetit

1. Secila palë ndihmon çdo person me banim jashtë shtetit për të ushtruar të drejtat e

siguruara nga ligji i brendshëm, duke bërë të efektshme parimet e parashikuara në nenin 8 të kësaj Konvente.

2. Kur një person i tillë është me banim në territorin e një palë tjetër, atij i jepet mundësia e paraqitjes së kërkesës me ndërmjetësimin e organit të caktuar nga ajo palë .

3. Kërkesa për ndihme përmban të gjitha hollësitë e nevojshme, duke shënuar ndërmjet të tjerash:

a) emrin, adresën dhe çdo të dhënë tjetër përkatëse, që identifikon personin që bën kërkesën;

b) dosjen e të dhënave personale të automatizuara për të cilën behet fjale në kërkesë, ose kontrolluesin e saj;

c) qëllimin e kërkesës.

Neni 15

Garancitë në lidhje me asistencën e dhënë nga organet e caktuara

1. Një organ i caktuar nga një palë, i cili ka manë një informacion nga një organ i caktuar nga një palë tjetër që shoqëron një kërkesë për ndihme ose në përgjigje të kërkesës së tij për ndihme, nuk e përdor këtë informacion për qëllime të tjera nga ato të përcaktuara në kërkesën për ndihme.

2. Çdo palë bën kujdes që personat që i përkasin ose veprojnë në emër të organit të emëruar t'u nënshtrohen detyrimeve të përshtatshme të fshehtësisë ose konfidencialitetit në lidhje me këtë informacion.

3. Në asnjë rast, organi i caktuar nuk mund të bejë kërkesë për ndihme në pajtim me nenin 14 paragrafi 2, në emër të një subjekti të dhënash me banim jashtë shtetit, pa iu bërë kërkesë dhe pa pëlqimin e dhënë shprehimisht nga personi i interesuar.

Neni 16

Refuzimi i kërkesës për ndihme

Organi i caktuar të cilit i është drejtuar një kërkesë për ndihme, sipas neneve 13 dhe 14 të kësaj Konvente nuk mund ta refuzojë, përveç kur:

a) kërkesa nuk përputhet me kompetencën e organeve përgjegjëse për kthimin e përgjigjes në fushën e mbrojtjes së të dhënave;

b) kërkesa nuk përputhet me dispozitat e kësaj Konvente;

c) përmbushja e kërkesës do të ishte në kundërshtim me sovranitetin, sigurinë ose rendin publik të palës nga e cila është bërë emërimi, ose me të drejtat dhe liritë themelore të personave nën juridiksionin e asaj palë .

Neni 17

Shpenzimet dhe procedurat e ndihmës

1. Ndihma e ndërsjelle që palët i japin njëra-tjetrës sipas nenit 13 dhe ndihma që ata u japin subjekteve të të dhënave jashtë shtetit sipas nenit 14 nuk duhet të shkaktojë pagesën e asnjë shpenzimi ose tarifash, përveç atyre për ekspertet dhe përkthyesit. Këto shpenzime dhe tarifa përballohen nga pala që ka caktuar organi që bën kërkesën për ndihme.

2. Subjektit të të dhënave nuk mund t'i ngarkohen shpenzime dhe tarifa në lidhje me hapat e marra në emër të tij në territorin e një palë tjetër, përveç atyre që paguhen ligjërisht nga personat me banim në atë palë .

3. Detajet e tjera në lidhje me ndihmën mbi format dhe procedurat dhe gjuhet që duhen të përdoren përcaktohen drejtpërdrejt ndërmjet palëve të interesuara.

KAPITULLI V KOMITETI KONSULTATIV

Neni 18

Përbërja e komitetit

1. Një komitet konsultativ krijohet pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.
2. Çdo palë cakton një përfaqësues në komitet dhe një zëvendës përfaqësues.
Çdo shtet anëtar i Këshillit të Europës, që nuk është palë në këtë Konvente, ka të drejtën e përfaqësimit në komitet më ane të një vëzhguesi.
3. me vendim unanim, Komiteti Konsultativ mund të ftojë çdo shtet joanetar të Këshillit të Europës që nuk është palë në Konvente për t'u përfaqësuar me një përfaqësues në një mbledhje të caktuar.

Neni 19

Funksionet e Komitetit

Komiteti Konsultativ:

- a) mund të bejë propozime në lidhje me lehtësimin ose përmirësimin e zbatimit të Konventës;
- b) mund të bejë propozime për përmirësimin e kësaj Konvente në pajtim me nenin 21;
- c) formulon mendimin e tij për çdo propozim për përmirësimin e kësaj Konvente që i është paraqitur në pajtim me nenin 21 paragrafi 3;
- d) me kërkesë të një palë, mund të shprehë mendimin e tij për çdo çështje që ka të bejë me zbatimin e kësaj Konvente.

Neni 20

Procedura

1. Komiteti Konsultativ thirret nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës. Mbledhja e tij e parë mbahet brenda 12 muajve që nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente, pastaj ai mbledhet të paktën një herë në dy vjet dhe për çdo rast kur një e treta e përfaqësuesve të palëve kërkojnë thirrjen e tij.
2. Një shumicë e përfaqësuesve të palëve përben numrin e nevojshëm për një mbledhje të Komitetit Konsultativ.
3. Pas çdo mbledhje, Komiteti Konsultativ i paraqet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës një raport mbi punën e tij dhe mbi funksionin e Konventës.
4. në bazë të dispozitave të kësaj Konvente, Komiteti Konsultativ përpilon rregullat e veta procedurale.

KAPITULL VI NDRYSHIMET

Neni 21

Ndryshimet

1. Ndryshimet e kësaj Konvente mund të propozohen nga një palë, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës ose Komiteti Konsultativ.
2. Çdo propozim për ndryshim u komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës shteteve anëtarë të Këshillit të Europës dhe shteteve joanetare që janë anëtarësuar ose janë ftuar të anëtarësohen në këtë Konvente në pajtim me dispozitat e nenit 23.
3. Për më tepër, çdo ndryshim, i propozuar nga një palë ose Komiteti i Ministrave, i komunikohet Komitetit Konsultativ i cili i paraqet Komitetit të Ministrave mendimin e tij për ndryshimin e propozuar.

4. Komiteti i Ministrave shqyrton ndryshimin e propozuar dhe çdo mendim të paraqitur nga Komiteti Konsultativ dhe mund të aprovojë ndryshimin.

5. Teksti i çdo ndryshimi, i aprovuar nga Komiteti i Ministrave në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, u paraqitet palëve për pranim.

6. Çdo ndryshim i aprovuar në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pasi të gjitha palët të kenë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e tij.

KAPITULLI VII DISPOZITAT PER FUNDIMTARE

Neni 22

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konvente është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtarë të Këshillit të Europës; ajo i nënshtrohet, ratifikimit, pranimit ose aprovimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit depozitohen të Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

2. Kjo Konvente hyn në fuqi në ditën e pare të muajit pas kalimit të një afati tre mujor pas datës në të cilën pese shtete anëtarë të Këshillit të Europës të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'iu nënshtuar konventës në pajtim me dispozitat e paragrafit të mësipërm.

3. në lidhje me çdo shtet që e shpreh pëlqimin e tij më vonë për t'iu nënshtuar Konventës, kjo hyn në fuqi në ditën e pare të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.

Neni 23

Anëtarësimi nga shtetet joanetare

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës mund të ftojë çdo shtet që nuk është anëtar i Këshillit të Europës të anëtarësohet në këtë Konvente nëpërmjet një vendimi të marre me shumicën e parashikuar në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Europës dhe me votën unanime të përfaqësuesve të shteteve kontraktuese që kane të drejtën e përfaqësimit në komitet.

2. në lidhje me çdo shtet që anëtarësohet, Konventa hyn në fuqi në ditën e pare të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së depozitimit të instrumentit të anëtarësimit të Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 24

Dispozita territoriale

1. Çdo shtet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit pranimit ose aprovimit ose anëtarësimit, mund të përcaktojë territorin ose pjesën e territorit në të cilën zbatohet kjo Konvente.

2. në një date të mëvonshme, çdo shtet, më ane të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund ta shtrijsë zbatimin e kësaj Konvente në çdo pjesë tjetër territori të përcaktuar në deklarate. në lidhje me këtë pjesë territori, Konventa hyn në fuqi në ditën e pare të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së marrjes së një deklarate të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklarate e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm, në lidhje me çdo pjesë territori të përcaktuar në këtë deklarate, mund të tërhiqet më ane të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja hyn në fuqi në ditën e pare të muajit pas kalimit të një afati prej gjashtë muajsh pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 25

Rezervat

Asnjë rezerve nuk mund të behet në lidhje me dispozitat e kësaj Konvente.

Neni 26
Denoncimi

1. Çdo palë mund të denoncoje në do moment këtë Konvente nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Një denoncim i tillë hyn në fuqi në ditën e pare të muajit pas kalimit të një periudhe prej gjashtë muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 27
Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtarë të Këshillit të Europës dhe do shtet që është anëtarësuar në këtë Konvente për:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitim të çdo instrumenti të ratifikimit, pranimi, aprovimit ose anëtarësimit;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në pajtim me nenet 22, 23 dhe 24;
- d) çdo akt, njoftimi ose komunikimi tjetër që ka të bëjë me Konventën.

Si dëshmi, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, e kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Strasburg, më 28 janar 1981, në anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet janë njësoj autentike, në një kopje të vetme, e cila mbetet e depozituar në arkivat e Këshillit të Europës.

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës u transmeton kopje të vërtetuara të gjitha shteteve anëtarë të Këshillit të Europës, Komunitetit Evropian dhe çdo shteti tjetër të ftuar për t'u anëtarësuar në Konventë.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

11.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

13.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
14.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

DOLI NGA SHTYPI

PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500
PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E DREJTËSISË	400

Doli nga shtypi më 8.11.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë